

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6789  
E premte, 23 dhjetor 2022  
çmimi 0.40 €

PSD-ja, aksion para  
zyrave të EULEX-it  
Vendimet e Speciales  
janë të padrejta | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KUVENDI KA MIRATUAR NË LEXIM TË DYTË PROJEKTLIGJIN PËR PAGA  
DHE ATË PËR ZYRTARËT PUBLIKË | FAQE 4-5

## OPOZITA THOTË SE DO T'I DËRGOJË NË KUSHTETUESE PROJEKTLIGJIN PËR PAGA DHE ATË PËR ZYRTARËT PUBLIKË



Deputetët e Kuvendit të Kosovës të enjten kanë miratuar në lexim të dytë Projektligjin për Paga në sektorin publik si dhe Projektligjin për Zyrtarët Publikë. Në të dyja

votimet e projektligjeve, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka abstenuar. Ndërkaq partitë opozitare nuk e kanë mbështetur Projektligjin për Paga

dhe as Projektligjin për Zyrtarët Publikë. Përfaqësuesit e opozitës kanë theksuar se këto dy projektligje t'i dërgojnë në Kushtetuese



OYTETARËT SERBËT  
PROTESTOJNË  
NË RUDAR,  
PARASHTROJNË  
KUSHTE PËR HEQJEN  
E BARRIKADAVE | FAQE 5



RASTI I FOSHJËS SË  
VDEKUR NË SPITALIN E  
PEJËS, LDK-JA E BËN  
PËRGJEGJËS KURTIN | FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

### AKTUALE



ZELENSKY PARA KONGRESIT:  
NDIHMA E SHBA-SË PËR UKRAINËN  
ËSHTË VENDIMTARE | F. 2

NË MEDIE DHE RRJETE  
SOCIALE PO PËRDORET GJUHË  
E URREJTJES DHE RACISTE | F. 7

KURTI PËRUIROI PARKUN  
E LODRAVE NË LAGJEN  
E KOMUNITETEVE NË GJYRKOC  
TË SHITES | F. 6

### EKONOMI



BOK-JA PARASHIKON 3 DERI  
4 PËR QIND RITJE EKONOMIKE  
NË VITIN 2023 | F. 8

AKP-JA BËN SHPALLJE PUBLIKE  
PËR QIRADHËNIEN E 196 PRONAVE  
SHOQËRORE | F. 8

### SPORT



ZYMBERI: PESË EMRA JANË NË LISTË,  
SË SHPEJTI E VENDOSIM  
PËR ÇËSHITJEN E TRAJNERIN | F. 12

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Zelensky para Kongresit: Ndhimja e ShBA-së për Ukrainën është vendimtare

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, foli para ligjvënësve amerikanë në Kongres dhe u takua me presidentin Joe Biden të mërkurën në një vizitë të jashtëzakonshme në Shtetet e Bashkuara, ku i bëri thirrje partnerit kryesor ndërkombëtar që ta vazhdojë mbështetjen ushtarake dhe ekonomike për luftën e Ukrainës kundër agresionit rus

**UASHINGTON, 22 DHJETOR** - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, u ka bërë thirrje ligjvënësve amerikanë dhe të gjithë qytetarëve të tjerë të ShBA-së që të vazhdojnë ta mbështesin vendin e tij me ndihmë ushtarake dhe financiare derisa lufton për ekzistencë kundër një Rusie revanshiste.

Çdo gjë tjetër, përveç fitores së Ukrainës, do ta kërcënonte botën e lirë, përfshirë ShBA-në, tha Zelensky. Ai i bëri komentet gjatë një fjalimi 25-minutësh para Kongresit Amerikan në Uashington. Ai tha se Ukraina mund ta fitojë luftën kundër një ushtrie ruse të armatosur më mirë, por shtoi se ndihma ushtarake dhe financiare e ShBA-së është "vendimtare" për ta arritur fitoren përfundimtare.

Mbrojtja e Ukrainës "nuk është vetëm për jetën, lirinë dhe sigurinë e ukrainasve. Ajo do të përcaktojë nëse [do të ketë] demokraci për ukrainasit dhe amerikanët", tha Zelensky.

Lufta "nuk mund të ngrihet ose shtyhet, nuk mund të injorohet, duke shpresuar se oqeani ose diçka tjetër do të sigurojë mbrojtje", tha ai.



Udhëtimi i Zelenskyt në ShBA u bë në kohën kur Kongresi po përgatitet të votojë një projektligj gjithëpërfshirës të shpenzimeve, që përfshin edhe një dispozitë për ndarjen e rreth 45 miliardë dollarëve ndihmë ushtarake për Ukrainën.

Projektligji pritet të miratohet, por mbështetja e ShBA-së për Ukrainën është zbehur, derisa lufta 10-muajshe vazhdon të zvarritet dhe amerikanët ndiejnë barrën e inflacionit të lartë.

Shumë anëtarë të Partisë Republikane, e cila do ta marrë kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve të ShBA-së në janar, kanë kritikuar ndihmën masive për Ukrainën në kohën kur ekonomia e ShBA-së vuan. Ata,

gjithashtu, kanë vënë në pikëpyetje mënyrën se si po përdoret ndihma.

Disa anëtarë të Partisë Demokratike, në anën tjetër, kanë shprehur shqetësim se ndihma ushtarake do ta provokojë Rusinë. Zelensky bëri përpjekje t'i adresojë këto shqetësime, duke thënë se ndihma e ShBA-së nuk është "bamiresi", por "një investim në sigurinë globale dhe demokracinë që ne e trajtojmë në mënyrën më të përgjegjshme".

Duke thënë se Ukraina është aleate e ShBA-së në luftën për demokracinë globale, ai vuri në dukje se Irani - të cilin Shtetet e Bashkuara e kanë etiketuar si shtet terrorist - është bërë aleat me Rusinë në luftën e saj kundër

vendit të tij, duke i shitur qindra dronë kamikazë vdekjeprurës. "Kështu një terrorist e ka gjetur tjetrin", tha ai, duke iu referuar etiketimit të Rusisë nga Ukraina si shtet terrorist. "Është vetëm çështje kohe kur ata do t'i godasin aleatët tuaj të tjerë nëse ne nuk i ndalojmë tani", tha Zelensky.

Zelensky "u foli amerikanëve në disa mënyra" gjatë fjalimit të tij, tha për "Radion Evropa e Lirë" Elise Giuliano, profesore dhe shkencave politike në Institutin Harriman të Universitetit të Kolumbisë për Studime Ruse, Euroaziatike dhe të Evropës Lindore. "Ai i bëri thirrje interesit tonë për ta mbrojtur demokracinë, por edhe sigurinë tonë", tha ajo.

Giuliano tha se Zelensky, në

mënyrë të zgjuar, ka përmendur mbështetjen e Iranit për Rusinë, sepse shumë amerikanë e identifikojnë Teheranin si një aktor "të keq" dhe "agresiv", të cilit ShBA-ja "duhet t'i kundërvihet". Vizita e Zelenskyt në ShBA ishte e para pas nisjes së pushtimit rus të Ukrainës më 24 shkurt.

Në Shtëpinë e Bardhë ai zhvilloi një takim me presidentin e ShBA-së, Joe Biden, me të cilin diskutoi për ndihmën dhe rrjedhën e luftës. Ai, po ashtu, zhvilloi bisedime me udhëheqësit e Kongresit nga të dyja partitë. "Dua që i gjithë populli i Ukrainës ta dijë se populli amerikan është me ju në çdo hap dhe ne do të qëndrojmë me ju", tha Biden.

Ai shpalli një paketë të re ndihme për Ukrainën - në vlerë prej 1.85 miliardë dollarësh - e cila përfshin edhe një bateri të sistemit mbrojtës raketor, Patriot.

Zelensky tha se sistemi Patriot është pjesa më e fuqishme e paketës së re.

Megjithatë, ky sistem nuk do të pozicionohet menjëherë, sepse trupat amerikane fillimisht duhet t'i trajnojnë forcat ukrainase se si ta përdorin dhe mirëmbajnë atë.

Patrioti konsiderohet si një nga sistemet më të avancuara të mbrojtjes ajrore amerikane dhe ofron mbrojtje kundër avionëve, raketave lundruese dhe atyre balistike.

Një sondazh i fundit i Këshillit të Çikagos për Politikën e Jashtme arrin në përfundim se megjithëse 65% e amerikanëve vazhdojnë ta mbështesin ndihmën e ShBA-së për Ukrainën, ata janë të ndarë midis mbështetjes "për aq kohë sa duhet" dhe dëshirës që Uashingtoni t'i kërkojë Kievit që të arrijë marrëveshje për paqe sa më shpejt të jetë e mundur.



# PSD-ja, aksion para zyrave të EULEX-it: Vendimet e Speciales janë të padrejta



PRISHTINË, 22 DHJETOR - Partia Socialdemokrate ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës Speciale për dënimin për krime lufte të ish-komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Salih Mustafa. Kjo parti ka mbajtur një aksion simbolik të enjten përballë zyrave të EULEX-it në Kosovë, duke theksuar se vendimet e Gjykatës Speciale janë të padrejta prandaj, sipas PSD-së, ato nuk mund të shqiptohen në emrin tonë. "Deklarimit të vendimit ndaj z. Salih Mustafa i parapriu shpjegimi politik; shprehjes 'në emër të popullit' iu dha sqarim nga Gjykata; mandati i saj, thoshte sqarimi, vjen nga Kuvendi i Kosovës. Prandaj dhe vendimet e kësaj gjykate rrjedhin nga populli i Kosovës. Por, përtej të qenit

sqarues, ky deklarim politik synonte diçka tjetër. Dhomat e Specializuara dëshirojnë legjitimitet përtej atij formal juridik sepse vendimet e kësaj gjykate nuk kanë legjitimitet te populli i Kosovës. E si të kenë tekta përbrenda ligjit, që s'frymon me konventa ndërkombëtare të drejtësisë, i hapet rruga gjykimit njëjetnik e me qëllim përfundimtar tjetërsimin e luftës çlirimtare në një konflikt interesash të ngushta vetjake", është theksuar në aksionin e kësaj partie. Të shtunën në orën 14:00, në sheshin "Zahir Pajaziti", PSD-ja ka thirrur protestë kundër vendimeve të padrejta të Gjykatës Speciale. Këtë protestë e kanë përkrahur edhe veteranët e luftës së UÇK-së.

## Rasti i foshnjës së vdekur në Spitalin e Pejës, LDK-ja e bën përgjegjës Kurtin

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka kërkuar dënimin dhe shkarkimin e të gjithë personave të përfshirë në rastin e foshnjës së vdekur, e cila u fut në rrobalarëse e mbështjellë me çarçafë në Spitalin e Pejës. Deputeti i kësaj partie, Armend Zemaj, në një konferencë për medie, ka thënë se ky rast tregon paaftësinë e qeverisë për ta menaxhuar sektorin e shëndetësisë, derisa e ka bërë përgjegjës kryeministrin Albin Kurti, duke e quajtur të "vetëmëruar ministër i Shëndetësisë". "Rasti i supozuar i ka kaluar të gjitha masat. Duhet të shkarkohen dhe të dënohen të gjithë ata që janë të përfshirë në rast si dhe ata që e kanë fshehur. Ka paaftësi të qeverisjes në shëndetësi, e kemi thënë gjithmonë, mirëpo rasti i foshnjës shkon përtej. Jo shumë ditë nga sot u vra edhe një nënë që shkoi për të lindur. Përgjegjës është Kurti si i vetëmëruar ministër i Shëndetësisë. Dorëheqje morale atyre që nuk janë drejtpërdrejt", ka thënë Zemaj. Për këtë rast ka reaguar edhe Spitali i Përgjithshëm i Pejës, i cili ka theksuar se në Repartin e

Gjinekologjisë të Spitalit të Përgjithshëm në Pejë në mbrëmjen e datës 13 të një shtatëz e shtrirë në Spitalin e Pejës është bërë diagnostifikimi i frytit të vdekur nga ana e mjekut kujdestar dhe, si rrjedhojë, ka ndodhur një intervenim kirurgjik dhe fetusi nxirret me prerje cezariene, i vdekur në javën e 32 të gestacionit. "Menjëherë me të ndodhur rasti organet e hetuesisë në njërën anë dhe paralelisht organet menaxheriale të Spitalit të Përgjithshëm në Pejë janë duke bërë hetime të detajuara lidhur me këtë rast. Duhet theksuar se hetimet nuk janë duke u bërë për ndërhyrjen kirurgjike apo përkujdesjen tjetër shëndetësore, por lidhur me mënyrën se si është bërë ruajtja e fetuesit të vdekur dhe tërë atë që ka ndodhur deri në dorëzim e fetuesit të vdekur te familjarët", ka njoftuar ky spital. Spitali i Përgjithshëm në Pejë ka njoftuar se me qëllim që të bëjë hetime të papenguara dhe të hollësisht për këtë rast, deri më tani ka suspenduar shtatë punonjës të Spitalit të Përgjithshëm në Pejë dhe janë duke u zhvilluar procedurat disiplinore me qëllim të zbardhjes së rastit.



## Pilotët e FSK-së përfunduan me sukses programin praktik të fluturimeve me helikopter

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Në Bazën e Farkës të Forcave Ajrore të Shqipërisë, pilotët e Njësisë së Aviacionit të FSK-së, përfunduan me sukses të lartë programin e rifreskimit teorik dhe praktik të fluturimeve me helikopter tip AB-206, me qëllim të ruajtjes së aftësive fluturuese individuale dhe operacionalitetit të njësisë sonë.

Ngritja e kapaciteteve ajrore e institucioneve të sigurisë së Republikës së Kosovës është nevojë për realizim të suksesshëm të operacioneve të përbashkëta ndërinstitucionale si dhe atyre të përbashkëta në reagime për menaxhim krizash me forcat e Shqipërisë dhe forcat e vendeve të tjera partnere rajonale mbi konceptin "Smart

defense".

Në kohën kur jemi në proces të ngritjes së kapaciteteve ajrore, ky program është shumë i rëndësishëm për rigenerim të shkathtësive operacionale të pilotëve tanë.

Mirënjohje dhe vlerësim i lartë për mbështetjen nga vëllezërit e motrat tona të Forcave Ajrore të Republikës së Shqipërisë.





KUVENDI KA MIRATUAR NË LEXIM TË DYTË PROJEKTLIGJIN PËR PAGA DHE ATË PËR ZYRTARËT PUBLIKË

# Opozita thotë se do t'i dërgojë në Kushtetuese Projektligjin për Paga dhe atë për Zyrtarët Publikë

Deputetët e Kuvendit të Kosovës të enjten kanë miratuar në lexim të dytë Projektligjin për Paga në sektorin publik si dhe Projektligjin për Zyrtarët Publikë. Në të dyja votimet e projektligjeve, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka abstenuar. Ndërkaq partitë opozitare nuk e kanë mbështetur Projektligjin për Paga dhe as Projektligjin për Zyrtarët Publikë. Përfaqësuesit e opozitës kanë theksuar se këto dy projektligje t'i dërgojnë në Kushtetuese

**EPOKA  
ERE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 22 DHJETOR** - Kuvendi i Kosovës ka miratuar të enjten në lexim të dytë Projektligjin për Paga në sektorin publik dhe atë për Zyrtarët Publikë. Në të dyja votimet e projektligjeve, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka abstenuar. Me Projektligjin për Paga në sektorin publik synohet të krijohet një sistem i njëtrajtshëm i pagave në sektorin publik, që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik.

Për të hyrë në fuqi Ligji për Paga duhet të nënshkruhet nga presidentja e vendit, Vjosa

Osmani.

Partitë opozitare nuk e kanë mbështetur Projektligjin për Paga dhe as Projektligjin për Zyrtarët Publikë. Ato përmes disa amendamenteve të cilat nuk kanë marrë miratim në Kuvend, kanë kërkuar rritje të koeficientit për punëtorë në disa sektorë, si në shëndetësi, arsim etj. Në projektligjin e miratuar në lexim të dytë nuk përcaktohet vlera monetare e koeficientit, por thuhet se "vlera monetare e koeficientit përcaktohet me ligjin vjetor të buxhetit".

Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Buxhetin, por nuk është përcaktuar ndonjë vlerë monetare e koeficientit për pagat e punonjësve të sektorit publik.

Deputetë të partive opozitare kanë kundërshtuar votimin e Projektligjit për Paga edhe për shkak të mospërfshirjes së vlerës monetare të koeficientit në projektligj.

Numri i punonjësve që marrin paga nga buxheti i Kosovës është rreth 83 mijë veta.

Deputeti Bekim Haxhiu nga subjekti opozitar, Partia Demokratike e Kosovës, tha se do ta kërkojë mendimin e Gjykatës Kushtetuese për Projektligjin për Paga.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se ky projektligj është mashtrim i radhës i qeverisë Kurti. "E tash që kaloi Ligji i Pagave, a ka dikush në qeveri që mund të na

tregojë sa është rroga e një zyrtari të shtetit? Terr informativ, manipulim dhe, siç po duket, edhe një mashtrim i radhës", ka thënë Tahiri.

Ligji i Pagave ishte miratuar një herë në shkurt të vitit 2019, por një muaj para se të niste zbatimin i tij - në janar të 2020-s - institucioni i Avokatit të Popullit e pati dërguar atë në Gjykatën Kushtetuese për, siç kishte thënë, "vlerësimin e përputhshmërisë" së tij me Kushtetutën e Kosovës. Gjykata, më pas, konstatoi se ligji i miratuar nuk ishte në përputhje me 11 nene të Kushtetutës dhe se shkaktonte "çrregullim të ndarjes së pushteteve në disfavor të gjyqësorit dhe institucioneve të pavarura".

Kuvendi i Kosovës në seancën e 22 dhjetorit ka miratuar në lexim të dytë edhe Projektligjin për Zyrtarët Publikë.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka reaguar pas miratimit në Kuvend të Ligjit për Zyrtarët

Publikë, i cili parasheh ndërprerjen e kontratave të punës për rreth 1 600 zyrtarë të nivelit të mesëm dhe të lartë drejtues dhe ripërcaktimin e këtyre pozitave me mandat katërvjeçar.

Kreu i PDK-së është shprehur se misioni i ri i qeverisë Kurti është largimi masiv nga puna i zyrtarëve publikë, shantazhimi, politizimi dhe nënshtrimi i tyre. "Keqqeverisja, punësimet partiake, skandalet në shëndetësi, dështimet në ekonomi dhe energji, ikja e të rinjve nga vendi, rrezikimi i sovranitetit dhe integritetit territorial të shtetit në vetëm dy vjet qeverisje nuk po i mjaftojnë kryeministrit Kurti dhe qeverisë së tij. Tani, përmes Ligjit për Zyrtarët Publikë, misioni i ri i kësaj qeverie është largimi masiv nga puna i zyrtarëve publikë, shantazhimi, politizimi dhe nënshtrimi i tyre. E gjithë kjo, duke shkelur të drejtat e njeriut dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës", ka deklaruar Krasniqi.

# Qytetarët serbët protestojnë në Rudar, parashtrojnë kushte për heqjen e barrikadave

EPOKA  
ERE

MAL QORRAJ

MITROVICË E VERIUT, 22 DHJETOR - Lirimi i serbëve të arrestuar, tërheqja e "listave sekrete për arrestimin dhe pushkatimin e serbëve", si dhe tërheqja e njësive speciale të Policisë së Kosovës nga veriu i Kosovës janë kushtet për heqjen e barrikadave të ngritura në këtë zonë, tha Goran Rakiq, kryetar i Listës Serbe, në protestën e mbajtur të enjten në Rudar të komunës së Zveçanit.

Goran Rakiq, kryetar i partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, Lista Serbe, tha se Kurti planifikon të "vrasë serbë" në barrikada, por nuk solli ndonjë provë që do t'i mbështeste këto pretendime. Në fakt, ajo që Kurti i tha gazetës britanike "Guardian" është se ai "shpreh shqetësim se heqja e barrikadave mund të çojë në viktima potenciale".

Protesta u mbajt në vendin ku ndodhet një nga nëntë barrikatat e ngritura nga grupe të serbëve lokalë pas arrestimit të ish-policit serb të Policisë së Kosovës, Dejan Pantiq, më 10 dhjetor. "Pa plotësimin e këtyre kushteve nuk do të ketë tërheqje të barrikadave, sepse jemi lodhur duke pritur se kush prej nesh është i radhës në listën për arrestim apo ekzekutim vetëm pse jemi serbë", ka thënë Rakiq, kryetar i partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, e cila vepron me mbështetjen e Beogradit zyrtar.

Ai tha se zgjidhja e kësaj krize është "ekskluzivisht në Prishtinë".

Ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, më 16 dhjetor, në një postim në



"Facebook", ka mohuar se Policia e Kosovës ka lista, sipas së cilave, arreston ish-policët e nacionalitetit serb.

Në fillim të protestës, turmës iu drejtuan djali i Dejan Pantiqit, Predrag Pantiq, ish-kryetari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Nikola Kabashiq, ish-kryetari i komunës së Zveçanit, Dragisha Miloviq dhe të tjerë nga sektori i arsimit dhe drejtësisë. Ata thanë se duan paqe, duan të qëndrojnë dhe të mbijetojnë në Kosovë, se nuk kanë asgjë kundër popullit shqiptar, por janë kundër qeverisë së Albin Kurtit. Ata i dënuan arrestimet në veri dhe dërgimin e

njësive speciale të Policisë së Kosovës në atë pjesë të Kosovës.

Qëllimi i arrestimeve, sipas tyre, ishte "frikësimi" i popullit serb. Kryetari i komunës së Shtërpçës, Dalibor Jevtiq, nga radhët e Listës Serbe, tha se "në këtë luftë serbët janë të bashkuar". Ai tha se qëllimi i Kurtit është që të mos ketë serbë në jug dhe në veri të Ibrit, ose të ketë "vetëm nga ata që duan t'i përulen".

Kurse disa nga qytetarët e mbledhur në Rudarë, me të cilët ka biseduar REL-i, thanë se kanë ardhur për të luftuar për të drejtat e tyre, por ka edhe nga ta që deklaruan se u detyruan të vijnë.

Tubimet e tilla janë "obligim pune" për punonjësit në institucionet serbe në Kosovë.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka theksuar se serbët në veri të Kosovës do ta kenë gjithmonë mbështetjen e tij për kërkesat e tyre. "Dhe nuk do të fshihem nga të mëdhenjtë dhe të fuqishmit në botë. Do të jem gjithmonë i përgjegjshëm për t'iu bërë thirrje që ta ruajnë paqen, sepse paqja është në interesin më të mirë të serbëve dhe të Serbisë, si dhe të popullit tonë në Kosovë dhe Metohi", ka deklaruar Vuçiqi në një video-adresim të publikuar në llogarinë e tij në "Instagram".

## Policia: 1 500 persona morën pjesë në protestën në Rudar

Protesta në Rudar të Zveçanit ka përfunduar e qetë, ka njoftuar Policia e Kosovës, duke demantuar spekulimet për gjoja pengimin e autobusëve në Shtërpçë, që kishin për qëllim shkuarjen në protestë. "Referuar deklaramëve dhe publikimeve të disa medimeve se, gjoja, autobusë me protestues të cilët kishin për qëllim shkuarjen në protestën e paraparë të mbahet në Rudar të Zveçanit, janë penguar nga Policia e Kosovës, janë të pavërteta dhe nuk qëndrojnë. Gjatë realizimit të detyrave dhe autorizimeve ligjore në funksion të garantimit të ligjit dhe sigurisë, një autobus është ndaluar sipas procedurave të kontrollit rutinor dhe gjatë verifikimit të dokumenteve disa persona nuk kanë pranuar të legjitimohen nga autoritetet kompetente, prandaj në mënyrë vullnetare (me vetëdëshirë) nuk kanë vazhduar tutje", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Policia e Kosovës siç ka njoftuar përmes komunikatës së saj para fillimit të protestës, ka theksuar njohjen e të drejtës ligjore për të protestuar në mënyrë të qetë nga secili qytetar si dhe angazhimet policore në respektimin e të drejtave dhe lirive njerëzore pa dallim. "Sipas vlerësimeve në terren rreth orës 13:00, protesta ka përfunduar e qetë, pa ndonjë incident të raportuar dhe në të kanë marrë pjesë rreth 1 500 pjesëmarrës", ka njoftuar policia.

## Koeficientet

Pagat e punëtorëve në Kosovë llogariten duke e shumëzuar koeficientin e pagës së një pozite me vlerën monetare të koeficientit. Raporti i koeficienteve është nga një deri në 18. Koeficienti më i lartë, 18, sipas Projektligjit për Paga, i takon vetëm presidentit të Kosovës.

Niveli i koeficientit 17.5 i takon kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

Koeficienti 17 i takon kryetarit të Kuvendit të Kosovës si dhe kryeministrit.

Për mjekët specialistë, koeficienti është 12.

Mësimdhënësit në shkolla fillore dhe ato të mesme të ulëta do të kenë koeficientin 5.6.

Ai ka theksuar se Ligji për Zyrarët Publikë bie ndesh edhe me detyrimet që Kosova ka marrë. "Gjithsesi, përballë këtyre tendencave kundërkushtetuese, Partia Demokratike e Kosovës nuk do të qëndrojë duarkryq. Ne do ta kundërshtojmë dhe do ta dërgojmë atë në Gjykatën Kushtetuese, ku, duke besuar në drejtësi, presim rrëzimin e padiskutuëshëm të tij", është shprehur Krasniqi.

Ndërsa deputeti i LDK-së, Driton Selmanaj, ka thënë se ky

Projektligj shpreh indinjatën e 80 mijë zyrarëve të administratës. "LDK-ja shpreh indinjatën për mbi 80 mijë zyrarët e administratës publike. Po dëshironi t'i jepni legalitet për ta shkatërruar këtë administratë. Me këtë Ligj po cenohet administrata. Kjo është mundësi për politizimin e kësaj administrate. Për herë të parë keni vendosur kriteret si në sistemin komunist. Me këtë Ligj po i ktheni kontratat mbi vepër", ka thënë Selmanaj.



## Rama së bashku me drejtoreshën e BERZh-it shëtutin në kryeqytet me trafikun urban

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka pritur të enjten në takim drejtoreshën menaxhuese të BERZh-it për Evropën Qendrore dhe Juglindore, Charlotte Ruhe.

“Pata kënaqësinë ta mirëpres drejtoreshën menaxhuese të BERZh-it për Evropën Qendrore dhe Juglindore, Charlotte Ruhe, e cila na përgëzoi për nënshkrimin e dy projekteve madhore për Prishtinën

‘UrbanTransportII’ dhe ‘Solar4Kosovo’”, ka bërë me dije Rama. Ai ka thënë se Ruhen dhe delegacioni përcjellës i saj kanë shëtitur në Prishtinë me njërin nga linjat e trafikut urban.



## Hamza nënshkruan memorandumin me ‘Qatar Charity’ në vlerë prej 365 mijë eurosh

MITROVICË, 22 DHJETOR - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, i shoqëruar nga drejtoresha për Mirëqenie Sociale, Drita Ibrahim, kanë pritur në takim drejtorin e organizatës “Qatar Charity”, Esam Dabab, me të cilin kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për finalizimin e fazës së fundit të projektit në Frashër. Me këtë rast, kryetari Hamza falënderoi organizatën “Qatar Charity” për mbështetjen e dhënë për realizimin e projekteve në sferën e mirëqenies sociale dhe për përmirësimin e kushteve të jetës për qytetarët e komunës

së Mitrovicës. Ndërsa drejtori i organizatës “Qatar Charity”, Esam Dabab, i tha kryetarit Hamza se bashkëpunimi me komunën e Mitrovicës do të vazhdojë edhe në të ardhmen, pikërisht për shkak të gjendjes së saj specifike. Bazuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi, është paraparë mobilimi i 45 objekteve në Frashër, prej tyre janë 40 shtëpi, shkolla, Qendra e Mjekësisë Familjare, Qendra Multifunksionale, Qendra Komerçiale dhe xhamia. Vlera e tërësishme e projektit arrin vlerën 365 mijë euro.



## Hakif Podrimqaku i ndihmon me 5 000 kilogramë miell 50 familje në Drenas

DRENAS, 22 DHJETOR - Kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur të enjten në takim Hakif Podrimqaku, i cili ka njoftuar se në sezonin e dimrit do t'i ndihmojë disa ekonomi familjare në nevojë të Drenasit. Lladrovci ka falënderuar Hakif Podrimqaku për

ndihmën e ofruar për familjet në nevojë dhe ka vlerësuar se kjo ndihmë do të jetë shumë e mirëseardhur për ato familje në këtë sezon dimri dhe kur dihet se shporta e ekonomisë familjare është rënduar për shkak të ngritjes së çmimeve. Donacioni i qytetarit nga

Drenasi, Hakif Podrimqaku, do të jetë 5 000 kilogramë miell, për 50 familje në nevojë. Hakif Podrimqaku do të ndajë edhe 50 metra dru për 25 familje, ndërsa si ndihmë për një ekonomi familjare do të ofrojë pagë mujore për tri vjet nga 150 euro.

## Kryetari i Deçanit mban takim të publik me qytetarët

DEÇAN, 22 DHJETOR - Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka mbajtur të enjten takim të publik me qytetarët e kësaj komune. Në këtë takim janë paraqitur projektet e realizuara gjatë vitit 2022 si dhe është diskutuar për

çështjet që i shqetësojnë qytetarët e Deçanit për ofrimin e shërbimeve cilësore komunale. Sipas Ramosajt, gjatë këtij takimi pranuan sugjerime dhe propozime lidhur me çështjet me interes të përgjithshëm. “Ftoj të gjithë qytetarët që edhe në

vitin e ardhshëm të vazhdojmë të jemi bashkëpunues në mënyrë që t'i realizojmë qëllimet tona për zhvillimin e qytetit, sepse pa koordinimin dhe angazhimin e plotë të qytetarëve nuk mund të kemi suksese”, ka thënë Ramosaj.



## Kurti përuroi parkun e lodrave në lagjen e komuniteteve në Gjyrkoc të Shtimes

SHTIME, 22 DHJETOR - Në lagjen e komuniteteve në fshatin Gjyrkoc të Shtimes, të enjten kryeministri Albin Kurti, së bashku me kryetarin e komunës së Shtimes, Qemajl Aliu dhe ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi,

përuroi parkun dhe këndin e lodrave. Në prani të fëmijëve, mësuesve e qytetarëve shqiptarë dhe ashkalinjë, banorëve të Gjyrkocit, u përuroi parku me sipërfaqe 2 200m<sup>2</sup>. Për vetëm dy muaj e gjysmë, me bashkëfinancim të

Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe komunës së Shtimes, është realizuar ky park me mbi 70 % hapësira gjelbëruese, me 570 pemë të mbjella, me 9 lloje të ndryshme të lodrave, me 52 shtylla ndriçimi, parking për vetura dhe 330m<sup>2</sup> shtigje për ecje.



# Në medie dhe rrjete sociale po përdoret gjuhë e urrejtjes dhe raciste

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Është mbajtur konferenca lansuese e raportit vjetor: "Luftimi i gjuhës së urrejtjes seksiste dhe raciste", në të cilën janë paraqitur të gjeturat kryesore nga monitorimi i portaleve dhe rrjeteve sociale ndaj grupeve të marginalizuara të shoqërisë me fokus gratë, komuniteti LGBTI+, minoritetet etnike dhe personat me aftësi të kufizuara dhe shpërndarjes së tyre në rrjete sociale. Rezarta Delibashzade-Krasniqi, drejtoreshë ekzekutive në

Institutin D4D, ka treguar se gjatë vitit është bërë monitorimi i 20 585 artikujve, prej tyre janë analizuar 3 461 lajme nga mediet.

Nga ky raport kanë dalë edhe rekomandime për politikanë që synojnë luftimin e gjuhës së urrejtjes në platforma mediatike. Ndër rekomandimet kryesore janë zhvillimi i një Kodi të Praktikës së Kosovës në përputhje me standardet e BE-së që gjendet në Kodin e Përforuar të Praktikës për Dezinformim (KPPD) më 2022. U theksua, po ashtu, se shoqëria civile e organizatat mediale duhet të

krijojnë dialog të qëndrueshëm dhe formal, me synim për ta mbështetur zhvillimin e legjislacionit gjithëpërfshirës për dezinformim dhe lajme të rreme.

Allen Meta, menaxher i projektit, ka thënë se një nga rekomandimet dhe pika kyçe që janë duke synuar si tek institucionet dhe tek aktorët kyçë është që të bëjnë një fushatë mbi edukimin medial. U bë me dije se ky rekomandim ka dalë edhe nga takimet që janë zhvilluar edhe gjatë takimeve me gazetarë dhe redaktorë.

Kurse Niman Hajdari,

zëvendësavokat i Popullit, ka thënë se është e rëndësishme të bëhet edukimi për të drejtat e njeriut sepse, sipas tij, është domosdoshmëri për një shoqëri demokratike. Ai ka theksuar se ky edukim duhet të ndodhë në shkolla dhe në universitete sepse, sipas tij, duke mos pasur një edukim, kemi raste të tilla ku atakohen grupe të ndryshme shoqërore.

Ndërsa Marigona Shabiu nga YIHR ka theksuar se kur është atakuar komuniteti LGBTI ka pasur fare pak reagim dhe mbështetje publike nga aspekti politik dhe as nga kryeministri.

"Kemi gjuhën e urrejtjes edhe ndaj 'Javës së krenarisë' dhe ndaj ofendimeve që u bëhen këtyre komuniteteve, po ashtu edhe komuniteteve të tjera që jetojnë në Kosovë nuk merret parasysh. Mirëpo ne si shoqëri civile duhet të jemi më vigjilentë pa marrë parasysh që institucionet duhet ta bëjnë punën e tyre", është shprehur ajo.

Bajram Ilazi nga Voice of Roma, Ashkali dhe Egjiptian, ka thënë se pjesëtarët e komuniteteve romë ashkali dhe egjiptian nuk ndërveprojnë me komunitetin shqiptar, andaj kjo lë të nënkuptojë se ata paragjykojnë.



## Pendarovski: Nuk do të ketë drejtësi derisa nuk shohim gjykatës dhe prokurorë në burg

SHKUP, 22 DHJETOR - Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, në fjalimin e tij vjetor të mbajtur të enjten para deputetëve, kritikoi pushtetin gjyqësor, politikanët dhe institucionet e tjera për praninë e lartë të korrupsionit në Maqedoninë e Veriut. Ai tha se "nuk do të ketë drejtësi derisa të ketë në liri gjyqtarë dhe prokurorë që marrin vendime skandaloze me motive korruptive" dhe e njëjta, sipas tij, duhet të vlejë edhe për politikanët që, sipas tij, janë shkaktarët e humbjes së besimit në organet e drejtësisë. "Nuk ka drejtësi nëse nuk ka politikanë aktualë në burg për korrupsion, por drejtësi nuk do të ketë derisa të jenë të lirë gjyqtarët dhe prokurorët që marrin vendime skandaloze që, ndoshta, fshihen pas motiveve korruptive", tha Pendarovski. "Shteti duhet t'i

vendosë kriminelët në burgje të tipit të mbyllur pasi në të kundërtën ata do të vazhdojnë t'i përdorin paratë e vjedhura nga populli për t'u paraqitur para qytetarëve si të ndershëm dhe të vërtetshëm. Nuk duhet të ketë vetëm arrestime për publikun, por dënime të gjata me burg dhe kthim të pasurisë së vjedhur. Por duhet të respektohet edhe prezumimi i pafajësisë, të mos i dënojmë njerëzit në publik para se të jenë dënuar nga një gjykatë kompetente", ka deklaruar Pendarovski.

Ai foli edhe mbi nevojën e ndryshimeve kushtetuese, për përfshirjen e pakicës bullgarë në të, si obligimin që del nga ai që njihet si "propozim francez" për zgjidhjen e kontestit me Bullgarinë.

Sipas Pendarovskit, të gjitha marrëveshjet e rëndësishme që kanë kaluar në legjislativ, si dhe



vendimet për ndryshime në Kushtetutë janë mbështetur nga opozita andaj edhe i bëri thirrje që t'i mbështesë pasi "qytetarët presin rezultate". "Askush nuk duhet t'i bëjë presion apo të kushtëzojë askënd që të votojë kundër vullnetit të tij por, duke e

bërë këtë, të gjithë deputetët duhet të jenë të vetëdijshëm për dy gjëra: së pari, përmbajtja e propozimit specifik, përfshirja e bullgarëve dhe e pjesëve të kombeve të tjera në Kushtetutë në asnjë mënyrë nuk e shkatërron identitetin

maqedonas dhe, së dyti, ata që janë kundër saj sot, nëse vërtet besojnë se BE-ja është qëllimi ynë strategjik, si do të votojnë për këtë ndryshim kushtetues kur do të jenë në pushtet?", tha Pendarovski.

Ai tha se askush nuk mund të garantojë se Bullgaria nuk do të vendosë kushte të reja sikur që nuk mund të garantojë se këtë nuk do ta bëjë ndonjë nga shtetet e tjera anëtare të BE-së.

Duke folur për agresionin rus në Ukrainë, Pendarovski tha se Maqedonia e Veriut do të vazhdojë ta mbështesë sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës, ndërsa akuzoi Moskën për kërcënim të sigurisë në Evropë si dhe për krizën energjetike dhe të ushqimit.

Presidenti maqedonas tha se "duke dënuar agresionin rus në mbrojmë edhe veten tonë".

# AKP-ja bën shpallje publike për qiradhënien e 196 pronave shoqërore

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka hapur shpalljen publike për qiradhënie të aseteve atraktive në shumë komuna të Kosovës. Gjithsej 196 prona do të lëshohen me qira në rajonin e Prishtinës 36 asete, në rajonin e Pejës 89 asete, në rajonin e Prizrenit 59 asete, në rajonin e Mitrovicës lëshohen me qira 4 asete dhe në rajonin e Gjilanit do të jepen me qira 8 asete.

Ky është një rast i volitshëm për ndërmarrësit që t'i zhvillojnë bizneset e tyre në asetet që janë të shpallura për qiradhënie nga ana e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Në rajonin e Prishtinës ofrohen asete tejet atraktive, nga të cilat 18 asete janë hapësira në "Grand Hotel" në qendër të Prishtinës, si restorante dhe taverna, hapësira për zyrë, hapësira komerciale me sipërfaqe mbi 400m<sup>2</sup> etj.

Po ashtu, kjo shpallje përfshinë edhe depo dhe objekte administrative në qendër të Prishtinës dhe në Graçanicë, si dhe një depo të derivateve të naftës në Ferizaj. Në rrethinën e Prishtinës ofrohen për qiradhënie edhe disa parcela

bujqësore në zonat kadastrale Cagllavicë, Graçanicë, Ilapllasellë, Banullë dhe Bardhosh.

Në rajonin e Pejës ofrohen me qira hapësira për zyra, dyqane, ndërtesa administrative dhe parcela bujqësore me sipërfaqe të ndryshme nga 7 ari deri në mbi 7 hektarë në komunat Deçan, Klinë, Istog, Pejë dhe Gjakovë.

Në rajonin e komunës së Prizrenit ka një numër më të madh të pronave që ofrohen për qiradhënie, konkretisht në komunat Suharekë, Rahovec dhe Malishevë ofrohen toka bujqësore me sipërfaqe të ndryshme deri në 9 hektarë, ndërsa në komunën e Prizrenit dhe Dragashit ofrohen lokale, depo dhe zyrë afariste.

Në rajonin e komunës së Gjilanit, në komunat Ferizaj, Gjilan, Klokot, Viti dhe Kamenicë, lëshohen me qira asete atraktive, nga të cilat 2 asete janë toka bujqësore me sipërfaqe afërsisht 4 dhe 8 hektarë, si dhe tokë, objekte, depo dhe pjesë të objekteve administrative.

Edhe në rajonin e Mitrovicës ofrohen për qiradhënie toka bujqësore në komunën e



Vushtrrisë me sipërfaqe nga 37 ari deri në mbi 4 hektarë. Dorëzimi dhe hapja e ofertave

dhe publikimi i çmimeve për ofertat që do të dorëzohen për këto prona mbahet më 4 janar

2023 në zyrat rajonale respektive të AKP-së në Prishtinë, Gjilan, Pejë, Mitrovicë dhe Prizren.

# BQK-ja parashikon 3 deri 4 për qind rritje ekonomike në vitin 2023



PRISHTINË, 22 DHJETOR - Kosova pritet që të ketë një rritje ekonomike prej 3 deri në 4 - përqindësh gjatë vitit 2023. Kështu ka thënë të enjten guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, në konferencën e fundvitit. Mehmeti ka thënë se këto parashikime janë të njëjta me ato që i ka dhënë Fondi Monetar Ndërkombëtar. "Sipas vlerësimeve të BQK-së, këtë vit parashikimet tona janë që rritja ekonomike në vend të sillet 3 deri 4 për qind, e që është ngjashëm me parashikimet që i jep edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar", ka thënë Mehmeti.

Duke arsyetuar parashikimet rreth rritjes ekonomike, guvernatori Mehmeti tha se edhe ekonomia e Kosovës u prek nga zhvillimet globale, siç është lufta e Rusisë në Ukrainë që, sipas tij, ndërpreu zinxhirin furnizues. "Ekonomia e Kosovës

filloi në vitin 2022 me perspektivë të mirë si rezultat i vitit të suksesshëm që ishte më 2021 e që u karakterizua me një rritje 10.75 për qind. Megjithatë, gjatë vitit 2022 ndryshimi i dinamikës globale, si dhe pasojat e luftës në Ukrainë, u shoqëruan me rritje të inflacionit, ndryshim të politikave monetare, rritje të normës së interesit dhe ngadalësim të rritjes së tregtisë botërore si rezultat i ndërprerjeve të zinxhirit të furnizimit e që u reflektua në aktivitetin ekonomik në nivel global, gjithashtu edhe në Kosovë", ka deklaruar Mehmeti.

Mehmeti foli edhe për remitencat që përbëjnë një komponentë të rëndësishme të ekonomisë së Kosovës. Sipas guvernatorit Mehmeti, remitencat në vitin 2022 arritën vlerën prej më shumë se 1 miliard eurosh duke thënë se kishte rritje prej 5.5-përqindësh.

## Punëtorët e KEK-ut përfitojnë nga 500 euro shtesë për fundvit

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka marrë vendim që t'u ndajë nga 500 euro shtesë të gjithë punëtorëve të kësaj korporate për fundvit. Këtë vendim e ka konfirmuar Sindikata e Re e KEK-ut

(SRKEK). "Të nderuar anëtarë të SRKEK-ut dhe punëmarrës të KEK-ut, sot morëm edhe konfirmimin nga drejtori menaxhues për 500 euro pagë shtesë për fundvit për të gjithë punëmarrësit e KEK-ut", është thënë në njoftimin e

SRKEK-ut. Po ashtu, kryesia e SRKEK-ut ka falënderuar të gjithë punëtorët për kontributin e tyre në punë dhe menaxhmentin e bordin e KEK-ut për këtë vendim, i cili do të jetë motivues për të gjithë.






BISEDË ME HYSEN TËRPEZËN (3)

# Thaçi dhe Krasniqi thoshin 'jemi gati të luftojmë', po do punë nuk i dinin

**Ju e kishit vendosur, me komunistë kurrë?**

– Unë isha i vendosur se me komunistë nuk shkoj kurrë! U lidhëm me dikë, por me kë të lidheshim? Sikur me fëmijë! Ta jep fjalën këtu, në krye të rrugës e ndryshon. Njeri pa shkollë është veç një copë mish me dy sy, se ai pak di. U lidhëm me Mulla Idrizin. Na patën mbetur tre inglizë në dorë. Tre muaj përpara a katër, ata i kish pas zënë rob gjermani nga Maqedonia, e duke i çuar për Berlin a nuk e di. Kur ka ardhur treni në Kaçanik, është bërë një alarm për një aeroplan amerikan. Ata kanë dalë prej trenit. Kanë marrë malin. I kanë zatet shqiptarët. Ua kanë marrë teshat e i kanë lanë veç në këmishë e në done. I ka parë dikush e më kallëzuan mua. Unë isha në Hogosht. E gjej një njeri për ta çuar në Viti. E gjej Hasan Kabashin. I thashë shko gjej ata njerëz e qiti nga Stublla. Atje ka katolikë, por shumë nacionalistë. T'i fshehim, se na vyejnë dikur. I kallëzova edhe kolonelit nga Dibra, se te ne pati ardhur ushtria shqiptare. Kanë gjetur një përkthyes, po nuk ka ditur mirë anglisht. Njëri kish qenë grek. Oficer i shtatmadhorisë greke. Kur u hallakat puna, erdhi Mulla Idrizi tek unë me Muharrem Fejzën. Edhe ky ishte intelektual. Brahim Kelmendin e njihja mirë, qysh kur kemi luftuar në '44-tën në Preshevë. Aty ka qenë luftë e madhe. Aty qenë vrarë shumë. Qe vrarë Sylja i Pozharanit. 12 veta janë vrarë. I kanë varret skaj Presheve, te Llojani. Në Runicë janë të vrarë 13. Katundin e kallën krejt. Panashecin, ashtu edhe Izvorin. Mulla Idrizi ish aty, edhe ky i kumanovsi. Ai gjithmonë ka qenë me bullgarë, por partizan. Këta kanë vdekur të gjithë. Isha asokohe i ri. Pata unë një fuqi të madhe. I mundëm aty. Na erdhi haberi që u kthyem edhe në Gjilan. Hyri Hitleti krejt. Kur erdhi Mulla Idrizi u mblodhëm ne. U bëmë nja 100 veta. Rexhep Kabashi i pruri edhe inglizët tek unë. Bile njërit, duke hëngër bukë, i kish mbetur buka në fyt. Unë nuk e kam ditur. Kam marrë vesh kur kam shkuar në Greqi. Atje kur jam takuar me ta, e kam marrë vesh. Ka qenë një djalë i hallës, edhe ai ka vdekur aty. Ai bënte hyzmet. Edhe Mulla Idrizi ishte aty. E kishin gjetur një djalë të ri, kishe pak për t'u marrë vesh me ta. Ata thoshin veç e dimë që këtë pushtet nuk e duam. Tash është luftë dhe tjetër nuk dimë. Biseduam me Mulla Idrizin. Ai po thotë më mirë t'i dorëzojmë, se mos të na i gjejnë në dorë. Këta janë ushtarë. I çuam për t'i dorëzuar në një vend. Pastaj u bë bujë e madhe. Çohet një hoxhë Nishevci, i Podujevës ka qenë, e bënë kishe



komandant brigade. E kisha Ibrahim Kelmendin dhe Luan Gashin. Luan Gashi kish pas bërë shkollë në kohën e Zogut në Tiranë. Edhe Adem Gllavica ka bërë shkollë në Serbi. Ademi deshi të dorëzohej, se ua kishte ndrequr shenjat e komunizmit krejt nxënësve. U mashtrua, ndoshta se ka qenë i ri. Mulla Idrizi më tha, shko nga Kosova mos po e takon dikë. Shkova unë. E mora Sadik Pozharanin me vete. Ishte trim. Shkuam në fushë të Harilaçit. Një herë e kisha parë Ademin në Ferizaj. Djalë i ri. Ka pas kryer shkollë kur ka qenë Jugosllavia. U nis me dy shokë me vete për t'u dorëzuar në Ferizaj. I ka thënë njëri se e kanë vënë flamurin. Unë ia ngjita për krahu: Adem, ku je, si je? Ku po shkon, more, të plasshin sytë?! Unë po e mbaj duke folur, po nuk po mund ta ndal. Kur po i shoh tre-katër veta kanë dalë prej Ferizajt duke ikur. Zoti na ruajt! Çka është, bre? Ai i njohu ata që iknin, se kishin qenë të asaj ane. Tha e vranë njërin, e rrëzuan flamurin tonë. Atëherë u ndal. I thashë a po e sheh? Eja në vete, se je intelektual? E kam aty Mulla

Idrizin, e kam Ibrahim Kelmendin e Luan Gashin. Të nesërmen erdhën nja 40-50 veta. Aty kanë qenë shpiti e xhandarmërisë në kohën e Jugosllavisë. Tash ato ishin të zbrazëta. Kishte vend për një mijë veta. Rrija në katund. Erdhi Mulla Idrizi me shokë. Erdhën edhe do prej Moravës këndeje. I mbaja me bukë në katund. Kam marrë bukë edhe nëpër serbë. Nuk pati ardhur hala ushtria. Dikush po thotë hala janë brigadat. Janë përgatitur në Prishtinë. Duke biseduar me Rrahmanin, ai po thotë: sa kohë duhet të luftohet? Do të rri gur më gur. Ai ish gati 60 vjeç. Aga Rrahman, i thashë, qysh po thua? Këtë gjë që po e lyp ti, nuk e di Ruzvelt, as Stalini i Rusisë, as kurrkush. S'dihet çka është. Duhet të luftojmë për komb e të kallëzojmë që ky vend është yni. Dolëm edhe në Kovilaçë. Atje ka qenë një kryeplak i fortë. Ai po thotë se i ka thënë komandantit që pa luftë nuk mund të dilni. Me ka çuar ai koloneli, a ka besë të flasë me ty. I thashë shko merre. Shkoi e pruri. Ai ishte me uniformë. Pak xhandarë me vete,

shokë. Ai tha unë jam ushtar. O sonte të gjendem në Shkup, o ta vras veten. Unë pa rënë nëpër Bresë nuk mund shkoj. Ashtu e kam rrugën. Thashë ne nuk jemi kriminelë. Ne jemi shqiptarë. S'duam të vritemi me kurrkënd. Ti je oficer e duhet të jesh i mençur. Ma jep fjalën që nuk e lakon udhën. Ish udha vijë e drejtë, që të mos hysh nëpër katund hiç, prej majës së Kopilaçës. Ishte vera, kështu më kujtohet. I thashë se je i rrethuar. Dolëm në një kodër edhe ne. Ishim goxha shumë, gati 200 veta. Kur kemi dalë në fushë të Kumanovës, kishin qenë të vdekur nja dy njerëz. Atyre ua shtinë flakën, mbasi dolën prej malit. Ushtria ishte aty. Njerëz të tjerë nuk pati.

**Pse s'e vrisnit ushtrinë e shkaut?**

– Jo! Ne nuk mund ta nisnim luftën prapë. Ne u kthyem këtej te ne prapë. Duke mbledhur njerëz. Unë e kam njohur vendin. Kam pasur lidhje me Ramiz Cërrnicën. E kam dashur shumë. Ka qenë tek unë sa isha në Hogosht. I thosha: Ramiz, po vjen dita. A është besa që do të

luftojmë? Besa është!

Më 14 nëntor isha në komunë. Po dua ta lëshoj komunën. Komunisti hala nuk kish ardhur, po u mor vesh kjo punë. Kur një ditë ra telefoni. Vllada Popoviqi, tha, prej rojës a nuk di ku! Mos luani tha, se ti edhe kryetari i Pozharanit jeni besnikë të shtetit të parë. Hajt, aga Ramiz, thashë, se nuk e kanë fjalën këta për kryetar. Ia mbylla telefonin. Kur të nesërmen komanda kish ardhur në Ferizaj. Hoxhë Nishevci ish bërë komandant brigade. Edhe ai ma shkruan një letër mua. Letra e shkruar serbisht. Hero je e patriot je e kështu e kështu në letër. Po t'i çoj nja disa me vje. Zini rrugën e Prishtinës me nja dy mijë veta, rrugën e Bujanocit, rrugën e Shkupit. Rroftë marshall Tita e rroftë Enver Hoxha e rroftë Fadil Hoxha! Marrim shtetin pa gjak. Letra e shkruar serbisht.

Aty kisha profesor Brahim Kelmendin (ka vdekur në Australi që 12 vjet). E ndala edhe Adem Gllavicën. Po e këndojnë letërn. Shkruaj, bre. Unë nuk di të shkruaj. Dynjaja jo u kall flakë, unë paqe nuk bëj me serbë. Unë dua luftë për tokat shqiptare. Të nesërmen a të pasnesërmen, shkruan letër Vllado Popoviqi. Serbisht edhe ai. Baballarët tanë kanë qenë miq. Më ka pas kallëzuar baba në luftën ballkanike ua kanë prishur edhe fenë. Sali Tërrnovcit ia kanë prishur fenë ose do t'ia prisnin krejt familjen. I kanë bërë rixha dy hoxhallarë që me të bëhej kurban për familje, por nuk kanë mundur t'ia ndërrojnë fenë. Baba tha, unë kam qenë lidhur në derë. S'e kanë prishur fenë. Njëfarë Giga i Gjilanit i bën suhal. S'e prish fenë, turk jam, turk do të vdes. Do të shkosh në xhenet, i kanë thanë dy hoxhallarë. Shpëtoji robtë! Pasi e mbushën nga goja me ujë për të kërcitur, u kthyen nga unë (rrëfen baba i Hysenit) e po thonë: O Sahit Tërpeza, ja do të pranosh edhe ti, ja do të të gjejë po kjo. Familjen e kisha larguar, tregonte baba. Në ato fjalë vjen dikush prej shkive. Kur këqyri, Toma! I bërtiti atij Gigës. Mos fol. Ky është njeri ynë. E kish pas shpëtuar baba një shka në kohë të Turqisë kur kish qenë në mal. I mbetet aty varri i hapur. Njeri nuk vdes. Mbasandej në Ferizaj, prej egjelit ka vdekur edhe ai.

Mirëpo, mbas dy vjetësh, rrotulloi puna. Serbia po, por nuk prek në fe, edhe namuz – jo. Mbasandaj kemi rrënuar në Jugosllavi, por në fe e namuz nuk ka prekur. Mirëpo, qe luftë e madhe ballkanike. Mbasi kaloi e lëshuan Sali Stanevcin. Atij ia solli Zoti t'i vrasë dy popa që e kanë kryqëzuar. E patën dënuar. I mbajti veç dy vjet burg dhe e lëshuan. Serbia e bëri me ligj të

mos preket feja. Bile ardhke te ne ai Saliu. I ka pas mbetur emri Sali Saha. Ka pas shkuar në Shqipëri dhe atje ka vdekur.

Unë i dija këto krejt, bre mixhë. Isha i betuar. Kur erdhi Mulla Idrizi, u bëmë kallaballëk. Me një fjalë, a kemi qenë 100 a 200, tepër tre mijë vetave.

**Ajo mbledhja që u mbajt për t'i rënë Ferizajt? Aty në atë librin që e ka shkruar Pirraku thotë se Mulla Idrizi ka thënë të mos i bihet Ferizajt, se po e marrim në qafë popullin? A e mbani mend këtë punë a jo?**

– Erdhi haberi. Ne vendosëm t'i binim më një dhjetor Ferizajt! Edhe Mulla Idrizin ta çonim, se mbledhja ishte në një katund të Gjilanit.

**Në Prelepnice?**

– Po! Në Prelepnice. (Po e harroj këtë emër shpeshherë). I thashë: Mulla Idriz, ti shko! Unë i bëra tre intelektualë, Ademin, Ibrahim Kelmendin, Luan Gashin. Kishim luftëtarë boll. Dikush t'i biem Gjilanit jo andej, jo kënde, mirëpo ai ka shkuar atje, mua më kanë rrethuar këtu, e unë s'po e dija! Ka ardhur dikush nga Pozharani, civil. Kur i kam parë unë, nja 30 të Pozharanit kanë dalë. Ditë ishte hala. Do andej, do kënde. Unë nuk këqyra shumë. Musli Pira ishte këtu. Kur u avit njëri tha: Aga Hysen. Nuk e di kush ka qenë, se po harroj. Turma u shpërnda. Do në të djathtë, do në të majtë. Më ka lëshuar Tahir Zhegoc, më ka lëshuar Ahmet Devaja, Sejda i Tahir Agës. Unë dihet që nuk pajtohem me ta. U këput puna ime. Njerëz pa shkollë. Një kryeplak çka thoshte, ashtu bënë krejt katundi. Këqyri, kishin mbetur edhe nja treqind-katërqind. Çka të bëj, ishte një sahat a dy para akshami. Dy veta me kuaj. Kishim boll kuaj, se i kemi pas zënë jesirë në

Maqedoni. I çojmë dy veta për t'i thënë Mulla Idrizit, mos e hallakat forcën në Prelepnice, se na hyri shkau. Ishin shkatërruar para meje, atje në Gjilan. Aty kish pas thënë Mulla Idrizi, ngadalë, bacë, se nuk po i biem njëherë. Ai e ka parë situatën. Po shkaktar është ky djallë, Muharrem Fejza, i flaktë, thotë, t'i biem aga Hysen. Por, jo, atë natë nuk i ramë. U prish ai plan. Ishte hala dritë. Hajde mos po e bëjmë edhe ndonjë andej nga Sllakoci. Ne ishim tepër treqind veta, prapë. Aty në Sllakoc, një nëse dilte, tre dilnin të tjerë. U terrua. Aty është një udhë që shkon nga bjeshka për Ferizaj. Dolëm në Fushë të Madhe. Bajrush Xhakli ish me nja 10 a 12 dhe ata ishin ndalur te muhaxhertë. Kur shkuam, tashmë ishte terruar. Kemi hyrë në odë të Qerim Qazës. E kisha motrën aty. Kur hyra, aty e gjeta Adem Qorin e Rahovicës. Si hyra tha: O Hysen Tërpeza, mos bre, se e merr popullin në qafë. Janë marrë vesh paria se do të bëhet me paqe. Hala pa u përgjigjur unë, një kushëri i tij i tha: Ju keni qenë me serbë gjithmonë, se ky është patriot e ju jeni tradhtarë. Ju jeni mësuar të jeni tradhtarë gjithmonë. Ai Sherifi u plagos atë ditë në Ferizaj. U ndalën fjalët, u çuam ne. Ademi, vëllai im, sa qe martuar, edhe një kushëri tjetër. U shpërndanë gati krejt. 27 kemi qenë Tërpeza krejt, të katundit, po nja dhjetë ishin tanët. Shkuam në fushë të Talinocit. Havaja ish mirë. Një dhjetor, që t'i biem Ferizajt. U thashë së pari të priten telat Prizren – Ferizaj. Gjashtë veta Prishtinë – Ferizaj, tre ishin kushërinj të mi. Të tretë kanë vdekur. Gjilan – Ferizaj pesëmbëdhjetë veta. Këtyre shkollarëve, pa dëgjuar kurrkush, u thashë rini këtu. Ishte terr e qetësi. Miza mund dëgjohej. S'ishte ftohtë, as kurrgjë. S'po dinë, ishin pa shkollë. E bëmë parullën **kripa-**

**buka.** E kuptuan menjëherë. S'po i dinë rregullat. T'i bihet një shteti. Kur dal, i numëroj, si sot, se kemi me dekë, si kur shkojmë për të vdekur. Kur i kam njuhur: dyqind e nëntëdhjetë e një a dy. Me ata s'ishin më shumë se treqind veta. Thashë, vëllezër: Zoti një. Thashë jemi të fortë. Shtatëqind veta jemi, tha Ademi, o dajë, me këta! I thashë nuk jemi aq. Po jemi më pak. Unë mendoj, ti më mirë e njuh udhën nga Kaçaniku. Udhë jonë që hyn për Ferizaj prej Gjilanit, në anë të majtë shtëpi nuk kishte më. Ka qenë një japi e madhe. Aty na patën thënë se është një brigadë a dy. Dy kishin qenë. Unë e kam Mulla Kadrinë të Llashnicës me vete. I rreptë. Bie shahadet. Na jep kurajë. Jemi ndarë ne në pjesë. E kemi lënë të hyjnë në Ferizaj arave. Kur dolëm te xhadeja që hyn në Ferizaj, ata ishin nisur dhjetë minuta pa shkuar ne. Ata ishin ndarë nga brigada për të shkuar në Prizren. Kur kanë dalë te xhamia e Ferizajt, janë zatet ballë për ballë me tanët. Ka krisur lufta. Aty janë vlarë shumë, 23-24 veta. U vra edhe kushëri im i dytë. Do janë plagosur. Aty u vra edhe një Ramizi i Tërpezës. Aty përpjetë, shkuam deri në vend. Kishin qenë veç do vajza, që kishin mbetur për ta ruajtur aty atë vend. Bërtitën e u tutën. Mos u tutni, bre, u thashë unë, s'do t'ju prekë kush me dorë. Krisi pushka, bam-bum... Dolën pa rregulla, pa disiplinë. Dilnin pa kurrfarë rregulli, nga një shtëpi në tjetrën. Duke dalë i vrisnin. Pa disiplinë! Tepër kemi bërë punë. Unë u pata thanë mendoni mirë. Do të luftojmë, por mos ta presim që të bëhet ditë, se si të na zërë dita në Ferizaj, s'mund të shpëtojmë asnjë. Brigadat në Kaçanik e në Ferizaj i mori komunizmi. Kërciste pushka në të gjitha anët. Në krejt Kosovën. Ashtu, duke dalë, u zbrit, kur

kemi mbërritur te kisha. Kisha që bërë ibret. Te kisha u vra një kushëri yni. Janë vlarë shumë të tjerë. Edhe kisha qe dëmtuar. Mbasandaj e kanë ndrequr. Mua më ka pas hyrë në zemër mendimi se pa luftë nuk çlirohet Kosova. Pa luftë nuk e lëshojnë serbët.

\*\*\*\*



**(Ndërron temë për pak)**

*Bile erdhi puna, unë shkoja kur u lirua Shqipëria, ishte Sali Berisha president. E mora një letër. I kisha do djem të motrës atje. Mua më ka respektuar qeveria e Tiranës shumë. Shkuam aty. Ishin bërë kallaballëk. Aty ishte Sali Berisha. Erdhi Rugova e do të tjerë. Unë po rri ashtu. Isha bërë operacion tri herë. Kisha pasur ymër, shpëtova. Jam mbështetur ashtu, shtagën nën këmbë. Fol, more Tërpezë diçka, po më thotë Rugova. Thashë, vallahi, unë po flas pak, por para se të flas, ju po më shihni. Nuk jam krenuar. I thashë, ju e keni gjetur një fjalë, veç me paqe. Ju a po i shihni çka bëjnë serbët me rrena e dallavere? Morëm vesh që po duan të bëjnë monumentin e Car Lazarit në Gjilan. Thashë, s'di të shkruaj emrin tim, por marr vesh. I kam pyetur profesorët se luftën e 600-vjetorit nuk e ka fituar Serbia. E ka fituar Turqia. Po mbasandaj, me çivia e kanë bërë kisha ka fituar Serbia. Thashë, Serbia nuk e lëshon pa gjak. Po mundohet ta sllavizojë krejt vendin. E kam provuar një herë. Kam dashur të bëj një telefon në Ferizaj. S'ka! Në i themi Ferizaj, po ata ia kanë vënë emrin Uroshevac. Thashë, duke i ditur këto, se nuk jam i trentë, unë u çova në luftë me dyqind-treqind veta. Me ata të shkohet në kafe diku, pak janë, jo t'i bihet një qyteti. Lufta, ndash me dhjetë, ndash me dhjetë mijë, luftë është, se po lufton për vend tënd. Si dihet, a fiton a s'fiton.*

*Besa, m'i ka mësuar Avni Kurteshi këto fjalë.*

*Ngadalë u çua në këmbë. I lig a, more! Ai u çua në këmbë e unë si i mbështetur këtej. Po vazhdon, mos u ngut, Tërpezë. Valla, bilah, tallah, i kemi punët që kurrë s'i kemi pasur më mirë. Hajde nesër në shtëpi të Enverit e bisedojmë. Shkuam atje, prapë u çua në këmbë, në ato fjalë erdhi ky Arbeni i Maqedonisë, është kryetar, po Arbën Xhaferi. Ai më respektonte shumë. Kur ma kanë bërë ditëlindjen, ma ka çuar një letër shumë të fortë. Letrat e mia i ka shpërndarë Klintoni nëpër gazeta. Kur të rrej ty, e rrej Zotin. Hallku e këqyrin interesin e vet. Dy herë më kanë lutur Anglia dhe Amerika që unë të pajtohesha me Jugosllavinë, po nuk kam pranuar. Me komunistë s'pranoj! Hajt, hajt, erdhi puna në Kongresin e Parë më bënë mua që të përzgjidhem në Kongresin e Dytë. Me patën propozuar për Kongresin e Dytë. E u lëshuan krejt edhe shokët përreth. Po kujtojnë që po mbaj hidhërim me Xhaferin, pse ka nisur të bëhet me gjermanë. S'më ka shkuar në mendje ajo punë. Kurrgjë s'ka ditur ai. S'më ka njohur mua.*

*Mos u ngut, o Hysen, se Salihu të ka ndër mend. Unë e kam mësuar historinë. Lidhja e Prizrenit ka lypur një Shqipëri etnike, trojet shqiptare nga janë. Tri herë e kish pas dënuar bota Lidhjen e Prizrenit. Ndale luftën, ndale luftën, s'e ka ndalur. Të katërtën herë Evropa i ka thanë Turqisë a po i ndal shqiptarët a jo? Ndoshta ti i di këto e po flas kot. Edhe i ra Turqia. I kam parë anijet angleze e franceze kur kanë dalë t'i bien Turqisë. Aty është puna. Po ne shqiptarë jemi, bre. Haxhi Zekën e mbyti Zajmi i Pejës. Ali Pashë Gucisë ia zunë paret, e mbyti Cerna Gorja. Tashti jemi në ujë. Zotit falë, kënaqem që po flas me ty. E di që e ki shqiptarinë në zemër e vdes për të. Nuk të*



*dhimbset jeta. Rugova u thotë amerikanëve: unë dua një shtet të pavarur, as me Shqipëri, as me Serbi, botërisht.*

### Hapur me Serbi e hapur me Shqipëri – si hani i Dilut?

– Dikush thotë, na edhe bëhemi idare edhe me një republikë. Edhe Thaçi për mua është gabim. Ka qenë këtu dhe ma ka pranuar. Më ka dashur fort. Bile mendo mirë kë e ke brenda. Ademi (Demaçi) thotë me Malin e Zi e me një Serbi e një "Ballkani" e s'di çka. Unë po ta them ty se si me ty kam folur me amerikanët. Ata përpiqen për një të ardhme që ju t'ju lënë pararojë. Ju ta ruani krejt Ballkanin, rojë e kufirit lindje të jenë shqiptarët.

### Forca kryesore në Ballkan?

– Forca kryesore.

### Sikur Serbia që ka qenë deri tash?

– Mbaroi lufta. Amerikanët në të '45-tën e humbën luftën. Detin e Zi e mori Rusia. Këta e humbën luftën. Lidhja e Kombeve, gjysma shkoi në Varshavë e gjysma mbeti. Mendojnë këta Lidhjen e Kombeve ta çojnë në Amerikë. I kanë nënshkruar krejt. Këta mendojnë që në një të ardhshme të flenë rehat, ju shqiptarëve t'ju lënë nën kontroll të serbëve. Trimërinë e kemi, po mendjen s'e kemi pasur hiç. Shkollë s'kemi pasur, këto na kanë kushtuar. Amerika kështu s'e pëlqen. As me Shqipëri, as me Serbi, kjo nuk u pëlqen amerikanëve.

Mua që të ma japin besimin, ma kanë dhënë kur kam dalë në Greqi. Armiku edhe po të rriste. Hysen Tërpeza ka dashur t'i rrëzojë tri shtete: Bullgarinë, Serbinë, Shqipërinë. U ka rënë qyteteve. Po të ngarkohej. Po, i kemi pas rënë Ferizajt. Po Amerikës i pëlqen që të kemi një Shqipëri Etnike dhe të mos e hallakatë kush më Ballkanin. Këto janë politika që duhen kuptuar.

Shtet i fortë, i fortë e besnik.

### Më besnikë se shqiptarët s'mund të gjejë?

– Më s'mund të flisja! E kam pasur të prerë. Kur më kanë marrë, unë s'kam ditur kurrë. Edhe Anglia shumë vjet ka punuar me Amerikë, po pak si me hile. E paska një det diku Anglia, s'e di ku, e deshën t'ia merrnin ata.

### Ishujt e Foklandeve, Argjentina ka dashur ta merrte...

– Shkoi Thaçeri atëherë në Amerikë. Ka qenë Regani president, e shpëtoi! Se me hile e kanë pasur anglezët. Kur kam qenë unë në atë grupin "monitor", anglezi ish ai që na i jepte drejtimet. Përkthyesi ish slloven. Unë serbishten e di më mirë se shqipen. E kam mësuar kur kam qenë i vogël. Më kanë thirrur mua dhe kam shkuar. Unë këtu, amerikani atje, po anglez ishte. Përkthyesi si atje. Unë jam aty. Mustaqet i kam ndrequr shpesh. Isha 42 a 43 vjeç. Po flet amerikani. Herë i bën dy gishta herë tre. E rrëzon një, këta mbeten dy. Prapë i bën tre.

Po thotë: Shiko Tërpezë, e kam një bisedë shumë sekrete. Ai, Nikollë emrin, po e thërrisnin Nik. Ai po thotë shoqi që e ke me vete nuk bën ta dijë. Ai ishte i Shqipërisë. Ka vdekur mbasandaj. Shkodran ka qenë, katolik, por shqiptar i mirë. Ishim bashkë. More, i thashë Nikut, ai është më besnik se unë, bre. E njihja për shqiptarizëm. Po, po, po thotë, por ai ka grua. Çka s'ndodh ndërmjet burrit dhe gruas. Këtë fjalë që po e flasim veç ne tre këtu duhet ta dimë.

### Po thotë anglezi?

– Po, anglez ishte, por puna ish sekrete!

### A folët mbasandaj veç ju tre, apo?

– Ai thotë se kjo veç asht si punë e vdekur. Askush nuk duhet ta dijë. I kam pasur edhe tre a katër kushëri, kanë vdekur, e tybe në paçin ditur kurrë. Përveç njërit që e ka ditur vonë, njëfarë Hajrullahu. Edhe ai, kur e ka ditur, erdhi puna t'i kallëzoja domosdo. Erdhi puna, se e lypete një vend. Edhe mbaroi ajo punë. S'po flas unë kurrëgjë. Hajt, hajt, hajt!

### Çka u bë më pastaj?

– Unë ia dhashë tre, por dy kanë jetuar e njëri kishte pas vdekur. E kishin pas mbytur bullgarët. E dy kanë jetuar deri vonë. Bile njëri (është i Kopilaçës), kam dëgjuar ka rënë në qytet diku. Është bërë pasanik i madh. Më duket e patën paguar mirë amerikanët.

### Si e pati emrin ai i Kopilaçës?

– Nuk e di, ka vdekur edhe ai. Çuditem me këto punë. Kur u bënë 40 vjet, unë dëgjova në radio, kur Amerika e njohu Maqedoninë. Po e njohu edhe Sali Berisha, ishte atëherë president. Rexhep Qosja e kundërshtoi Sali Berishën. Mark Krasniqi u zemërua pse kundërshtoi Qosja dhe e kundërshtoi atë. Kështu, Marku dha dorëheqje nga Akademia. Ka dhjetë vjet kjo punë. U bë një mbledhje këtu në Bernë. Mua



më thirrën të thosha një fjalë për këtë trepërqindëshin. Ishte një Galimuna aty. Ishin dyqind-treqind veta. Qe bërë vonë atë ditë. Ishte nga ora 11. U çua njëri, larg atje, e tha aga Hysen, kush është më gabim tash, Amerika që ka bërë punën e vet, apo Rexhep Qosja që e kundërshtoi. A më mirë që e njohu Amerika dhe Sali Berisha? Mark Krasniqi e akuzoi

Qosjen pse ka kundërshtuar, kush është më gabim?

Ato janë punë të mëdha. Nuk e di kush as sot. Unë do gjëra që i di, nuk i dinë as ata akademikët. Puna e Maqedonisë, që e ka njohur, këto janë punë të Amerikës. Kjo është një rrugë nëpër të cilën amerikanët mendojnë të shkojnë më larg.

### Korridori i tetë?

– Tamam mbas 40 vjetësh, edhe këta zabunat morën kuvet. Me këtë punë erdhi hesapi që as Rusia nuk mundi të bëhej kundër Amerikës. As Kina nuk mundi të ndihmonte, edhe pse është komuniste. As japani nuk bëri gjë. Duhet të dihet se edhe japani nuk është mirë me Amerikë.

### Ato dy bombat atomike?

– Heeeee... Njëqind mijë ia mbyti atëherë. Hala lindin sakatë. U zbutën! Këto janë, për shembull, punët e Amerikës. Tani kanë shkuar për t'i vizituar ato shtetet që janë në Varshavë.

### Kryesore juve po ju nderon. Po jua bën aeroportin afër. Amerika po na e bën në Sojevë. Veç në derë të na e bëjë?

– Është bërë një punë që miliarda nuk e kishin zanë. Ka pasur rast kur nuk mund të flisja e ata bëheshin nervozë. Të flisja keq unë për Adem Demçin a për ndonjë tjetër, me vinte marre. A gojarisht mund t'u them.

### Pështy përpyetë të bie syve?

– Këto janë meseletë.

Tash unë po të kallëzoj. A ka bërë mirë a ka bërë keq, bëje hesap vetë! UÇK-ja u formua dhe ka bërë luftë. Po të mos kishte luftuar UÇK-ja, nuk kanë pasur si ta bombardojnë Jugosllavinë.

### Na kanë thënë amerikanët aty kur kanë ardhur. E keni gabim që thoni NATO. Së pari është UÇK-ja, pastaj NATO-ja?

Presidenti amerikan e çoi atëherë Hollbrukun. I tha shko thuaj Rugovës duhet të merret vesh me UÇK-në. Ai hala ka thanë: Jo, unë jam njeri i paqes. More, ai po e mbron pragun e derës, e ky: Jo, unë jam njeri i paqes. Na ka dëmtuar shumë ky njeri.

### Ajo paq(j)a asht edhe gjellë?

– Këto janë gjëra që na kanë dëmtuar. Më është bërë tullusum ky njeri. Tashti ne jemi plakur edhe ligështuar. S'po mund të dal përjashta pa më ndihmuar dikush.

Nuk janë punët mirë as sot. Armiku nuk fle. E kam thanë në Gjilan e në Prishtinë. Mendoni mirë, se Sllobodani po thotë: hala nuk e kemi humbur luftën. Vallahi bilahi i ke do njerëz edhe prej nesh që mendojnë ashtu!

### Sa të duash.

– Me Thaçin a Krasniqin nuk jam takuar. Ndoshta nuk kanë nevojë për ne, por do gjëra që i di unë, ata hala nuk i dinë. Ata tashti nuk duhet të rrinë. Ajo Amerika tashti po thotë formojeni një qeveri provizore e rregulloni gjërat. Heshtja jonë është dëm. Si e kemi punën me Preshevë, dihet. Ata ishin dy-tri herë këtu. Ata thanë ne jemi gati të luftojmë. Shkiet do të na bien një ditë.

### Kishin qenë duke u frikuar shumë?

– Kam hëngër bukë në ato katunde. Një Xhagaduri ka qenë pasanik. Kam qenë me Mulla Idrizin aty. Krejt parinë e kisha me vete.

Erdhën këtu e thanë: Aga Hysen, ne ty po të njohim mirë. Jemi të lumtur. Nga Zoti e nga ti i kemi sytë. Puna jonë, jemi në rrezik. U thashë mos u ngutni. Ne do të vdesim. Ata janë trima të mëdhenj. Tashti këta këtu, çka të rrinë, puna është e dëmshme. Nuk duhet të rrinë hiç. Ta formojnë një qeveri qyshdo. Këta amerikanët nuk duan të thonë, qe, ne po ta formojmë qeverinë. Formoje vetë. Unë e bëra deri këtu e ju vazhdoni. Çka rrinë më këtu këta, pse presin?

*(Intervistë e realizuar nga Sami Dërmaku, botuar në librin "Dëshmi kohe" nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Vizion nesër) /Epoka e re/*





**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Zymeri: Pesë emra janë në listë, së shpejti e vendosim për çështjen e trajnerin

**GJILAN, 22 DHJETOR** - Eliminimi nga Kupa e Kosovës përballë Lirisë ishte një dështim që drejtuesit e Dritës nuk e pranuan dhe morën vendim për shkarkimin e trajnerit Ardian Nuhiu. Që nga shkarkimi i tij, një muaj më parë, kampioni vjeshtor i Kosovës vazhdon edhe më tutje të jetë pa trajner, por kjo situatë do të ndryshojë brenda pak ditësh. Kështu ka bërë me dije për "KosovaPress", drejtori sportiv i Dritës, Valon Zymeri. Ai ka thënë se në listën e ngushtë tyre tashmë janë pesë emra dhe se trajneri i ri duhet të jetë dikush që e njih mirë Superligën e Kosovës. "Nga ajo çka kemi pasur analizë dhe çka kemi diskutuar brendapërbrenda klubit kemi ardhur në përfundim që duhet dhe është më e mira që për këto gjashtë muajt e ardhshëm, me mundësi vazhdimi edhe për disa vjet të tjera ndoshta, të jetë një trajner i cili e njih Superligën e Kosovës dhe konkretisht e njih pak a shumë Dritën si funksionon", ka thënë Zymeri. "Kjo është e para, pastaj nga analizat që kemi bërë, nga ata emra të cilët janë lakuar brendapërbrenda takimeve që i kemi pasur me presidentin dhe me udhëheqësin e klubit, e kemi bërë një listë të ngushtë prej pesë emrave të cilët i kemi kontaktuar dhe po mundohemi t'i përpunojmë ato të dhëna që i



kemi marrë nga ata trajnerë dhe të shohim se cili është trajneri më adekuat për të vazhduar me Dritën", ka shtuar Zymeri. Në mesin e këtyre emrave është edhe ish-trajneri i Malishevës, Arsim Thaçi, gjë të cilën e ka

konfirmuar edhe Zymeri. "Pa diskutim, një prej emrave që e kemi kontaktuar, por janë edhe katër trajnerë të tjerë të cilët i kemi kontaktuar dhe mbi këta pesë emra ne do ta bëjmë një analizë shumë të detajuar dhe në fund do

ta marrim një vendim se cili do të jetë trajneri i cili do ta udhëheqë Dritën në të ardhmen. Pa asnjë diskutim, këta emra, të cilët i kemi futur në listën e ngushtë, janë trajnerë shumë të respektuar, janë trajnerë që ne kemi shumë

respekt për ta dhe besojmë, por që vetëm njëri prej tyre mund të bëhet", ka deklaruar Zymeri. Ndryshe, Drita e ka mbyllur edicionin vjeshtor si kampione me 38 pikë pas 18 xhirove të zhvilluara.



## Përfundon afati kalimtar në basketboll

**PRISHTINË, 22 DHJETOR** - Ka përfunduar afati kalimtar në basketboll për lojtarët vendorë nga klubet e Prince Caffè Superligës. Klubet mund të përforcohen me basketbollistë të huaj deri në 72 orë para fillimit të

xhiros së 22-të të garave të elitës. Sigal Prishtina është përforcuar me dyshen nga Marigona Hill Prishtina, Enver Memqaj dhe Eris Zenelin, si dhe lojtarin nga ShBA, Gach Both. Trepça u përforcua me Musab Malën nga Rahoveci,

kurse Peja me Samir Zekiçin e Trepçës, kurse Vëllaznimi ka marrë Jahi Carson nga Rahoveci. Ndërkohë, Vreshtarët janë përforcuar me Arion Ballukun nga Bashkimi dhe Ujkan Karanezin nga New Basket.

## Renditja e FIFA-s, Brazili në pozitën e parë, Kosova e 107-ta

**PRISHTINË, 22 DHJETOR** - FIFA ka zbuluar zyrtarisht renditjen e saj dhe kryesimin që e mban Brazilin, edhe pas eliminimit nga Botërori i Katarit në çerekfinale. Argjentina është

shpallur kampione e botës dhe qëndron në vendin e dytë, ndërsa Franca finaliste në vendin e tretë. Më pas në renditje vijnë Belgjika, Anglia, Holanda, Kroacia, Italia,

Portugalia dhe Spanja. Përfaqësuesja e Kosovës renditet në pozitën e 107. Shqipëria ka fituar një pozitë duke u ngjitur në vendin e 66.



## Lorina Kuka eliminohet nga 'Jerusalem Masters 2022'

**PRISHTINË, 22 DHJETOR** - Xhudistja Loriana Kuka i ka dhënë fund shumë herët përvojës në "Jerusalem Masters

2022". Kuka është eliminuar qysh në rrethin e parë të garës prestigjioze që po mbahet në Izrael. Në kategorinë deri në 78

kilogramë, Loriana u mposht nga ukrainasja Yelyzaveta Lytvynenko. Duhet cekur se Distria Krasniqi u stolis me

medalje të artë e Laura Fazliu me atë të argjendtë, kurse Nora Gjakova zuri vetëm vendin e pestë.



## Federeri: Nadali ishte nga të parët që mori vesh për pensionimin tim

Cyrih, 22 dhjetor - Roger Federeri u tërhoq nga sporti në shtator të këtij viti kur luajti për herë të fundit në lojën dyshe me mikun e tij Rafael Nadal në turneun e Laver Cup. Në një intervistë për mediet zvicerane, "king Roger" zbulon se rivali e

miku i tij spanjoll, me të cilin zhvilloi ndeshjen e fundit në karrierë, ishte nga të parët që mori vesh tërheqjen e tij nga sporti. "Pas përfundimit të US Open e mora në telefon dhe zhvilluam një bisedë shumë emocionuese. Rafaeli ishte nga

personat e parë, përveç atyre të familjes dhe stafit tim, që mësoi për tërheqjen time nga sporti", kujton Federeri. Më tej, Federeri ka shtuar: "I thashë: Përhëndetje Rafa! Para se të vendosësh për të luajtur në turne të tjerë, dëshiroj që të

vish në Laver Cup për të luajtur me mua ndeshjen time të fundit në karrierë, në lojën dyshe. Do të ishte fantastike ta mbyllja me ty. Për fat të keq, gjuri im nuk është në rregull dhe ky është fundi i karrierës time".



## Zërina Shatri, MVP e javës së pestë

PRISHTINË, 22 DHJETOR - Xhiroja e pestë dhuroi disa ndeshje interesante në Ligën Unike të Femrave. Kjo ishte xhiroja e fundit për stinorin vjeshtor, ku Flamurtari shënoi pesë fitore në pesë ndeshje. Prishtina shënoi fitore të thellë ndaj Penzës, ku efektshmërinë apo indeksin më të lartë e kishte Zërina Shatri, 33, që ishte më e larta e kësaj xhiroje, duke u shpallur edhe MVP e javës së pestë të Ligës Unike. Zërina ndeshjen ndaj skuadrës pejane e mbylli me 18 pikë, dhjetë kërcime, gjashtë asistime, pesë topa të vjedhur dhe tri bllokada. Flamurtari mundi Partizanin për t'u shpallur kampion dimëror, ndërsa si zakonisht u dallua Samra Omerbasiq me 22 pikë, 15 kërcime dhe një asistim. Ndërkohë, Bashkimi mundi Tiranën në udhëtim, ku u dalluan tri lojtare: Talyah Hopkins me 31 pikë, 11 kërcime, tri asistime, Arbnore Përçuku me 21 pikë, nëntë kërcime e tetë asistime dhe Aulona Muhadri me 13 pikë, 16 kërcime dhe një asistim.



### Top pesëshja

Zërina Shatri	(Prishtina)	18 pikë, 10 kërcime, 6 asistime
Talyah Hopkins	(Bashkimi)	31 pikë, 11 kërcime, 3 asistime
Samra Omerbasiq	(Flamurtari)	22 pikë, 15 kërcime, 1 asistim
Arbnore Përçuku	(Bashkimi)	21 pikë, 9 kërcime, 8 asistime
Aulona Muhadri	(Bashkimi)	13 pikë, 16 kërcime, 1 asistim

## Brooklyni mposhti kampionët e Golden States

BROOKLYN, 22 DHJETOR - Fitorja e shtatë radhazi për Brooklynin, që mundi me rezultat 143-113 kampionët e Golden States, në një ndeshje të dominuar nga Netsi. Tetë basketbollistë të Brooklynit realizuan mbi 10 pikë (Duranti me 23 pikë më i miri). Humbet edhe Milwaukee, që u ndal me rezultat 114-106 nga Clevelandi, ndeshje ku Antetokounmpo realizoi 45 pikë e 14 rebounde, por që s'mjaftuan. Për cavaliersat u



dalluan Mitchell me 36 pikë e Garlandi me 23 pikë. Skuadra e lakersave u mund me shifrat 134-120 nga Sacramento, humbja e dytë radhazi, duke zbritur në renditje. LeBron Jamesi me 31 pikë e 11 asistime ishte më i miri për lakersat, por që s'mjaftuan, ndërsa

për Sacramenton të gjithë titullarët realizuan mbi 13 pikë. Luka Donçiqi realizoi 25 pikë e 10 asistime në fitoren me rezultat 104-99 ndaj Minnesotas, ndërsa Bostoni u mund me rezultat 117-112 ndaj Indianas (Haliburtoni 33 pikë).

### REZULTATET

Cleveland - Milwaukee	114-106
Philadelphia - Detroit	113-93
Atlanta - Chicago	108-110
Boston - Indiana	112-117
Brooklyn - Golden State	143-113
New York - Toronto	106-113
Houston - Orlando	110-116
Minnesota - Dallas	99-104
Oklahoma - Portland	101-98
Sacramento - Lakers	134-120
Clippers - Charlotte	126-105

## UEFA: Ndeshja Bjellorusi - Zvicër do të zhvillohet në Serbi

UEFA ka vendosur që ndeshja ndërmjet Bjellorusisë dhe Zvicrës të zhvillohet në Novi Sad të Serbisë. Si Bjellorusia ashtu edhe Zvicra ndodhen në të

njëntin grup në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian "Euro 2024", aty ku është edhe Kosova. Ky vendim i UEFA-së vjen pasi Bjellorusia nuk ka të

drejtë t'i zhvillojë ndeshjet në territorin e saj për shkak të invazionit rus në Ukrainë, por duhet t'i luajë ato në stadione neutrale. UEFA ka vendosur që ndeshja

ndërmjet Bjellorusisë dhe Zvicrës që është paraparë të zhvillohet me 25 mars, të luhet në stadiumin "Karadjodje" të Novi Sadit të Serbisë. Kjo do të jetë një

tjetër sfidë e rëndësishme për Xherdan Shaqirin dhe Granit Xhakën. Ata të dy ishin pjesë e Zvicrës edhe në ndeshjen që e eliminoi Serbinë nga Kupa e Botës në Katar.

### SHKURT

## Kosovare Asllani bëhet femra e parë që merr çmimin 'Këmba e Artë'

Futbollistja kosovare Kosovare Asllani ka marrë një çmim special. Çmimi i ndarë nga Principata e Monakos, "Golden Foot" apo Këmba e Artë për femra, i ka takuar Kosovare Asllanit. "Një nga ato netët e veçanta. Shumë krenare dhe e nderuar që shkruaj historinë duke marrë çmimin e parë 'Këmba e Artë', për një lojtare femër", ka shkruar Asllani. "Pjesa e veçantë me këtë çmim është se fituesi lë një kallëp të përhershëm të gjurmëve të tyre në Shëtitoren e Kampionëve, në breg të detit të Principatës së Monakos", ka shtuar ajo. "Ky çmim përfaqëson futbollin e femrave dhe sa larg ka arritur, por gjëja më e mirë është se ne sapo kemi filluar", ka përfunduar futbollistja me renome botërore.

## Jo vetëm Ancelotti dhe Ziande, por edhe Enrique në listën e Brazilit

Jo vetëm Carlo Ancelotti dhe Zinedine Zidane, në listën e dëshirave të Federatës Braziliene, ka përfunduar edhe Luis Enrique. Pesë herë kampionët e botës po kërkojnë një trajner të ri pas largimit të Tites dhe, sipas "O Globo", Luis Enrique është një mes tre kandidatëve favoritë. Enrique është i papunë, menjëherë pas zhgënjimit në Botëror, Federata Spanjolle vendosi të mos i rinovojë kontratën. Gjithnjë sipas medieve braziliene, filozofia e Luis Enriques përshtatet në mënyrë perfekte me stilin dhe lojën e Brazilit.

## Jorginho: Dua të qëndroj te Chelsea

Jorginho e ka shprehur haptazi dëshirën për të qëndruar te skuadra e Chelseat. Mesfushori nuk dëshiron që ta mendojë largimin dhe, tash kur kanë filluar diskutimet në lidhje me rinovimin e kontratës së tij, "sigurisht që dua të qëndroj, e dua Chelsean. Puna është se nuk do të mendoj për këtë tani. Më duhet të mendoj për t'i fituar ndeshjet, përndryshe është problem", ka thënë Jorginho për "Talksport".

## Brazili në ankth, përkeqësohet gjendja e Peles

Prej tre javësh i shtruar në një spital në San Paolo, Pele vijon të jetë në terapi intensive, por gjendja e tij shëndetësore jo vetëm që nuk po përmirësohet, por vjen në përkeqësim. Sipas raportit të fundit mjekësor, "ka një progresion të sëmundjes onkologjike dhe kërkon trajtim të mëtejshëm në lidhje me mosfunksionimin e veshkave dhe zembrës". Në lidhje me gjendjen e Peles, ka reaguar edhe vajza e tij, Flavia Arantes: "Krishtlindja jonë në shtëpi është anuluar. Së bashku me mjekët kemi vendosur që, për shumë arsye, është më mirë të qëndrojmë këtu, me të gjithë mjekimet e duhura".



Në bazë të funksioneve dhe kompetencave që parashihen në nenin 21, lidhur me nenin 17 pika 17.1 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, neni 8 të Ligji Nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ 07/2017, Rregullores nr. 01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 dt.13.07.2022 dhe në bazë të vendimit nr.4239 dt.21.12.2022, KA shpallë këtë:

### KONKURS PUBLIK

Shpallet konkurs publik për kohë të caktuar për vendin e punës në ndërmarrje si në vijim:

- **Pozita e punës:** Zyrtar/e për Auditim të Brendshëm
- **I përgjigjet:** Komisionit të Auditimit
- **Kohëzgjatja e punës:** 3 vite
- **Niveli i Pagës:** II.

#### Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Komisioni i Auditimit dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat d,f,k dhe l të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidati duhet të ketë:

- Diplomë Universitare në: Ekonomik, Juridik, Administratë Publike, Financa Publike apo fusha të tjera të studimeve relevante;
- Certifikatë të Auditorit të Brendshëm sipas legjislacionit në fuqi si dhe Kontabilist i Certifikuar;
- Përvojë pune së paku 5 vite (2 vite përvojë pune specifike në Auditim);
- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional;
- Të jetë objektiv dhe i paanshëm;
- Njohja e mirë e ligjeve dhe rregullore në fuqi me theks të veçantë Ligjin për NP dhe ligjet tjera që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin e financave;
- Aftësi të komunikimit, planifikimit të punës dhe udhëheqjes së aktiviteteve të Auditimit;
- Aftësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi të bashkëpunimit me menaxhmentin dhe stafin e ndërmarrjes;
- Aftësi të delegimit dhe monitorimit të autoritetit dhe përgjegjësisë tek bashkëpunëtorët për kryerjen e funksioneve të deleguara;
- Njohuri të avancuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe pakove standarde softuerike;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi.

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheq, menaxhon si dhe bën organizimin e brendshëm të Zyrës së Auditimit duke zgjedhur stafin e tij;
- Përpilon procedurat e Auditimit, gjegjësisht planin e Auditimit të Brendshëm për të gjitha transaksionet e Ndërmarrjes, konform objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të Ndërmarrjes, të bazuara në Ligjin e aplikueshëm;
- Auditimi i planeve investive dhe financiare të ndërmarrjes, planit vjetor të biznesit dhe buxhetit vjetor;
- Auditimi i pasqyrës vjetore të bilancit dhe deklaratat e fitimeve dhe humbjeve si dhe deklaratat financiare që kërkohen me ligj;
- Vlerësimi objektiv dhe shfrytëzimi efektiv i burimeve të Ndërmarrjes si dhe dhënia e rekomandimeve adekuate për Komisionin e Auditimit;
- Verifikon përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë funksionimin e ndërmarrjes sipas Ligjeve në fuqi;
- Gjatë ushtrimit të veprimtarisë ti siguroj Komisionit të Auditimit çfarëdo vërejtje apo sugjerime të cilat konsiderohen të nevojshme;
- Verifikimi i rregullt i përshtatshmërisë dhe funksionimit i rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i ndërmarrjes, duke përfshirë dokumentacionin financiar mbahet në përputhje me standardet e kontabilitetit, Ligjin dhe që projekt deklaratat vjetore financiare të përgatiten në mënyrë të rregullt;
- Analiza e sistemeve dhe proceseve të biznesit dhe kontrolleve të ndërlidhura me to;
- Raportimi i rregullt para Komisionit të Auditimit dhe përmbushja e çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga Komiteti i Auditimit;
- Udhëheq dhe drejton të gjitha aktivitetet e Auditimit të Brendshëm;
- Përmbush çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga ana e Komisionit të Auditimit nëse ekziston;
- Për punën e tij i përgjigjet dhe i raporton Komisionit të Auditimit.

#### Dokumentacioni i kërkuar:

Kandidati/ja duhet t'i dorëzojë këto dokumente në formë fizike në zyrat e Trafikut Urban në zarfë të mbyllur:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com/2022/njoftimet-e-konkurseve/aplikacioni-per-pune/>);
- Një CV të detajuar;
- Dëshmi mbi shkollimin, kopjet e diplomave mbi kualifikimin, diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Letër motivimin;
- Kopje të certifikatave;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust;
- Deklaratën nën betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit të NP e cila mund të shkarkohet nga ueb faqja e ndërmarrjes;
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;

-Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

#### Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

#### Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm në formë fizike në zyrat e Trafikut Urban.Konkursi është i hapur nga data 23.12.2022 dhe përfundon më datë 06.01.2023 në ora 16:00.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 22.12.2022

2

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com) email: [info@trafikurban-pr.com](mailto:info@trafikurban-pr.com) tel: +383 45 10 11 33



Na osnovu funkcija i ovlašćenja predvidenih članom 21, u vezi sa članom 17 tačka 17.1 Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, Zakon br.04/L-111 o izmenama i dopunama zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, Član 8 Zakona br. 03/L-212, Administrativno uputstvo 07/2017, Uredba br. 01/2022 za unutrašnju organizaciju i sistematizaciju radnih mesta sa br. 1827 od 13.07.2022 godine i na osnovu rešenja broj 4239 od 21.12.2022.godine, KR je objavio:

### JAVNI KONKURS

• Javni konkurs se raspisuje na određeno vreme za radno mesto u preduzeću i to:

- **Radno mesto:** Službenik za Unutrašnju Reviziju
- **Odgovara:** Komitetu za Reviziju
- **Trajanje rada:** 3 godine
- **Nivo plata:** II.

#### Zahtevi i potrebne kvalifikacije:

Komisija za reviziju želi da osigura da su svi kandidati lica visokog integriteta koja ispunjavaju kvalifikaciju uslove prema članu 17.1, kao i da ispunjavaju kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2 tačke d, f, k i l Zakona o javnim preduzećima i da imaju potrebno stručno iskustvo i obrazovanje potrebno za predmetno radno mesto.

Pored ovih opštih uslova, kandidat mora imati:

- Univerzitetna diploma iz: ekonomije, prava, javne uprave, javnih finansija ili drugih relevantnih oblasti studija;
- Sertifikat internog revizora u skladu sa zakonima na snazi kao i ovlašćenog računovođe;
- Radno iskustvo od najmanje 5 godina (2 godine specifičnog radnog iskustva u reviziji);
- Da ima visok moralni i profesionalni integritet;
- Da budi objektiv i nepristrasan;
- Dobro poznavanje zakona i propisa na snazi sa posebnim akcentom na Zakon o JP i druge zakone koji se odnose na unutrašnju kontrolu i finansijsko upravljanje;
- Veštine komunikacije, planiranja rada i vođenja aktivnosti revizije;
- Istraživačke, analitičke, evaluacione veštine i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost saradnje sa menadžmentom i osobljem kompanije;
- Sposobnost delegiranja i praćenja ovlašćenja i odgovornosti saradnicima za obavljanje delegiranih funkcija;
- Napredna znanja u korišćenju informacionih tehnologija i standardnih softverskih paketa;
- Poznavanje engleskog jezika se smatra prednošću.

#### Dužnosti i odgovornosti:

- Vodi, rukovodi i organizuje unutrašnju organizaciju Kancelarije za reviziju birajući njeno osoblje;
- Sastavlja procedure revizije, odnosno plan unutrašnje revizije za sve transakcije preduzeća, u skladu sa ciljevima unutrašnje kontrole, politikama i procedurama preduzeća, na osnovu zakona na snazi;
- Revizija investicionih i finansijskih planova preduzeća, godišnjeg poslovnog plana i godišnjeg budžeta;
- Revizija godišnjeg bilansa stanja i bilansa uspeha, kao i finansijskih izveštaja propisanih zakonom;
- objektivnu procenu i efikasno korišćenje resursa Društva, kao i davanje adekvatnih preporuka Odboru za reviziju;
- Verifikuje prikladnost i pravilan rad sistema i procedura koje imaju za cilj da garantuju rad preduzeća u skladu sa zakonima na snazi;
- Tokom obavljanja aktivnosti dostavljam Komitetu za reviziju sve primedbe ili sugestije koje smatram neophodnim;
- Redovna provera podobnosti i pravilnog funkcionisanja sistema i procedura koje imaju za cilj da obezbede da se knjige i dokumentacija preduzeća, uključujući finansijsku dokumentaciju, vode u skladu sa računovodstvenim standardima, Zakonom i da se nacrti godišnjih finansijskih izveštaja pripremaju uredno;
- Analiza poslovnih sistema i procesa i povezanih kontrola;
- Redovno izveštavanje Komiteta za reviziju i ispunjavanje bilo kog drugog zadatka koje odredi Komisija za reviziju;
- Vodi i usmerava sve aktivnosti interne revizije;
- Obavlja sve druge dužnosti koje odredi Komisija za reviziju, ako ih ima;
- Za svoj rad odgovara i izveštava Komitet za reviziju.

#### Potrebna dokumentacija:

Kandidat je dužan da dostavi ova dokumenta u fizičkom obliku kancelarijama za "Trafiku Urban" u zatvorenoj kovčeri:

- Prijava za zapošljavanje (preuzeta sa veb stranice TU <https://trafikurban-pr.com/2022/njoftimet-e-konkurseve/aplikacioni-per-pune/>);
- Detaljan CV;
- Dokaz o obrazovanju, kopije diploma o kvalifikaciju, diplome stečene u inostranstvu moraju biti ovjerene;
- Kopija lične karte;
- Motivacija pismo;
- Kopije sertifikata;
- Dokaz o dokazanom radnom iskustvu u Trustu
- Izjava pod zakletvom u skladu sa članovima 17.1 i 17.2 Zakona o JP koja se može preuzeti sa sajta kompanije;
- Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci;

#### Opšte informacije:

– Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.

– Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angažovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.

#### Način primene:

Prijava se može podneti samo u fizičkom obliku u kancelarijama "Trafiku Urban".

Konkurs je otvoren od 23.12.2022 i završava se 06.01.2023 u 16:00 časova.

Napomena: Nepotpuni dokumenta i onih koja pristignu nakon konkursnog roka neće biti pregledane.

**Datum: 22.12.2022**

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com) email: [info@trafikurban-pr.com](mailto:info@trafikurban-pr.com) tel: +383 45 10 11 33



Në bazë të nenit 21 paragrafi 21.4 e Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr.03/L-087, si dhe Plotesim Ndryshimi i Ligjit mbi NP Nr.04/L-111, si dhe Kodi Etikes dhe Qeverisjes Korporative, Bordi i Drejtorëve të KRM "Pastrimi" SHA-Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur me 30.11.2022, vendosi të publikoi këtë:

### KONKURS Për plotësimin e pozitës:

**Kryeshef Ekzekutiv i Kompanisë**  
**I përgjigjet:** Bordit të Drejtorëve.  
**Vendi i Punës:** Prishtinë

**Paga:** Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.  
**Kohëzgjatja e emërimit:** Mandati për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv është 3 vjeçar.

#### Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Të menaxhoj kompaninë në baza ditore në pajtim me aktet ligjore dhe politikën e kompanisë,
- Të zbatojë qëllimet strategjike dhe objektivat e kompanisë duke i dhënë drejtim lidhshëm drejt arritjes së misionit dhe vizionit të kompanisë,
- Mbështet punën e Bordit të Drejtorëve me anë të propozimeve lidhur me politikën dhe vendimet që do të merr Bordi;
- Është përgjegjës për shërbimet që ofron kompania duke mbikqyrë kualitetin e programit të përgaditjes së shërbimeve, marketingun dhe shitjen e këtyre shërbimeve,
- Propozon buxhetin vjetor për aprovim të Bordi i Drejtorëve, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregullore të aplikueshme,
- Në mënyrë efektive menaxhon resurset njerëzore të kompanisë brenda politikave zyrtare të kompanisë dhe procedurave konform ligjeve në fuqi,
- Siguron që misioni dhe programi i Kompanisë dhe i shërbimeve të saj, të jenë në mënyrë të vazhdueshme dhe fuqishëm të prezantuar për të krijuar një pasqym pozitiv të kompanisë të palët e interesit,
- Mbikqyrë ngritjen e fondeve, planifikimin dhe zbatimin e tyre, duke përfshirë identifikimin e burimeve të financimit, si dhe përgaditjen e strategjisë për të i'u qasur këtyre burimeve duke ofruar propozim për administrimin dhe dokumentimin e ngritjes së këtyre fondeve,
- Menaxhon politika dhe zbaton vendimet e Bordit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

#### Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 Një person ka të drejtë të shërbejë si drejtor vetëm nëse i plotëson të gjitha kushtet më poshtë si dhe kushtet për pavarësi dhe përshtatshmëri profesionale të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 17 të këtij ligji: dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

Përveç kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të vecanta:

- të kenë diplome universitare nga fusha ekonomike, juridike, teknike, shoqërore ose të ngjashme.
- të kenë përvojë profesionale përfshirë së paku 5 vjet në nivelin drejtues në insitucione shtetërore apo nga sektori privat .
- të kenë integritet të lartë moral e profesional,
- të kenë aftësi të dëshmuara në udhëheqje ose menaxhim,
- njohja e gjuhëve të huaja do të ketë përparësi,
- të mos jenë të dënuar ose nën hetime.

Aplikacionit për pozitën e KE-se duhet bashkëngjitur edhe këto dokumente:

- CV-ne (Biografine),
- Kopjen e leternjoftimit,
- Planin personal zhvillimor strategjik të ndërmarrjes për 3 vitet e ardhshme
- Letër motivimin,
- Deklaratën nën betim
- Diplomën e fakultetit - kopje, (e noterizuar)
- Certifikatën që nuk është nën hetime .


#### Aftësitë, përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

Duhet ose të ketë së paku pesë (5) vite përvojë – së paku në një nivel të lartë të menaxhmentit – në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim i thesari, banka, konsulentë në biznes ose industri ose nga një fushë tjetër e shkencës ose njohurisë e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së; ose për së paku pesë (5) vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlihet ngushtë me veprimtarinë afariste të NP-së

#### Data e mbylljes së konkursit:

Konkursi është i hapur 30 ditë kalendarike nga dita e publikimit reseptivisht prej datës 07.12.2022 deri me dt 07.01.2022 .

**Procedura për aplikim:** Aplikacioni merret në Kompani, të njëjtit i bashkëngjiten dokumentet deklarata nën betim , kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, të diplomuarit në universitetet jashtë vendit t'ia bashkëngjisin dëshminë e nostrifikimit të diplomës, dëshminë për përvojën e punës –trustin, dëshminë se nuk janë nën hetime apo te dënuar për vepër penale.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "2 VO" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 810831489.

- Valton Jahaj shpall të pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Xhemajl Bytyqi shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Nahim Hamza shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Agon Muhameti shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Blendi Biraj shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Agime Thaqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Vjollca Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Mjekësisë "Hysni Zajmi".

- Fakte Domi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Lumnije Makolli –Maliqi, shpall të humbur Licencën e Punës të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës.

- Lumnije Makolli shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme të Mjekësisë "Ali Sokoli" Prishtinë.

- Zenel, Hajdar Ramadani nga fshati Çirez, komuna e Skenderajt, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lëshuar nga Gjumnazi "Hamëz Jashari" në Skenderaj.

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

